



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4/2024 regjistër (JR)
Datë 30.01.2024

Nr. 78 i vendimit
Datë 03.11.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 03.11.2025, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Herila Çela, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 710, datë 30.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Herila Çela (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti ka përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave*.
 - 2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, sipas parashikimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, ka dërguar pranë Komisionit raportin², ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Herila Çela.
 - 2.3. KLGj-ja, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Herila Çela³.
3. Komisioni kreu hetimin e plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke konkluduar se:
 - 3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] (i) *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën 1.000.000 lekë, për krijimin e depozitave pranë*

¹ Raporti i ILDKPKI-së me shkresën nr. {***} prot., datë 19.11.2019.

² Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 14.07.2023, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. {***} prot., datë 33.02.2021.

OTP Bank, në vitin 2006. (ii) Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në shumën 848.073 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank (me nr. {***}) dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera. (iii) Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.890.000 lekë, për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, në datën 14.01.2012. (iv) Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.129.846 lekë, për krijimin e depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe Union Bank, pasi: (a) kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.100.000 lekë për kryerjen e depozitimit në datën 18.05.2004; (b) kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë. (v) Kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 235.207 lekë për blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 03.02.2007. (vi) Kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar krijimin e shumës prej 9.968.097 lekësh, shtuar në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” të pasqyrave financiare për vitin 2010.

Referuar konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive të trajtuara më lart, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 6.103.126 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b” e “d”⁴ të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: [...]subjekti i rivlerësimit [...] ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

3.4. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues çmon se, duke marrë në konsideratë problematikat lidhur me situatën e konfliktit të interesit në përfitim të ardhurave nga fondet publike, përfshirë edhe gjykatën në të cilën subjekti ushtronte funksionin, si dhe problematikat e evidentuara në vlerësimin profesional dhe denoncimet nga publiku, si më lart arsyetuar, subjekti i rivlerësimit e ka cenuar me sjelljen e tij besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se numri më i madh i problematikave të evidentuara në vendim janë nga ankesat e publikut dhe denoncimet nga publiku, të cilat kanë rezultuar të drejta pas hetimit nga ana e Komisionit. Pesha e këtyre mangësive në vlerësimin tërësor të subjektit është e tillë, që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit

⁴ Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit, duke lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “d”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe, si rrjedhojë, Komisioni konkludoi se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të gjyqtarës do të ishte jo në përputhje me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të neneve 61, pika 5 dhe 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në përfundim, Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 710, datë 30.10.2023, ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Herila Çela, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.*

II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

5. Kundër vendimit nr. 710, datë 30.10.2023, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Herila Çela, nëpërmjet të cilit kërkon: (i) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) Konstatimin e shkeljeve të të drejtave Kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut; (iii) Administrimin e provave bashkëlidhur ankimit, si dhe (iv) Ndryshimin e vendimit nr. 710, datë 30.10.2023, të Komisionit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Herila Çela.

5.1.1. Lidhur me shkaqet procedurale të ankimit, subjekti i rivlerësimit pretendon për: (i) Shkelje të nenit 6, pika 1 dhe nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe respektimit të jetës private, pasi Komisioni nuk ka dhënë arsye bindëse për largimin e tij nga praktika e mëparshme gjyqësore, duke aplikuar standard të dyfishtë në procesin e rivlerësimit. (ii) Moskalimin e barrës së provës për fakte dhe shkaqe me ndikim në vendimmarrjen e Komisionit. (iii) Zbatimin e gabuar të kuadrit ligjor të aplikueshëm, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, si dhe (iv) Çmuarjen e çështjeve të karakterit profesional në tejkalim të kompetencës së organeve kushtetuese të rivlerësimit.

5.2. Lidhur me shkaqet e ankimit që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, pretendon:

5.2.1. Për dy depozitat në ish-Bankën Societe Generale Albania ShA, përkatësisht në vlerën 944.735 lekë dhe vlerën 630.507 lekë, pretendon se ka provuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, me të ardhura nga shitja e tokës truall me sipërfaqe 2.680 m², nga nëna e subjektit.

5.2.2. Lidhur me depozitat në ish-Bankën e Kursimeve (sot, Raiffeisen Bank ShA), përkatësisht në vlerën 500.000 lekë dhe vlerën 539.346 lekë, pretendon se ka provuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Komisioni për periudhën 1997 – 2003, nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti i personit fizik, për vitet 2001 – 2002.

5.2.3. Për depozitat, përkatësisht në vlerën 2.800.000 lekë, në Intesa Sanpaolo Bank ShA dhe në vlerën 2.776.000 lekë, në Union Bank ShA, të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, duke u ndalur në origjinën e hershme të krijimit të tyre, subjekti pretendon se si burim kanë shërbyer edhe kursimet *cash*, të disponuara nga prindërit e saj, të cilat së bashku me kursimet e bashkëshortit u depozituan nga ky i fundit në emër të babait të subjektit.

5.2.4. Për pasurinë, automjet tip “Chevrolet”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, është në kundërshtim me provat e administruara, si dhe me praktikën e vetë Komisionit.

5.2.5. Lidhur me konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit, për shkak të përfitimit të ardhurave si rezultat i lidhjes nga shoqëria tregtare e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të kontratave me institucione të ndryshme publike, subjekti pretendon se, në kushtet kur nuk është konstatuar asnjë indicie e qenies së saj në keqbesim, kjo gjetje e Komisionit nuk mund të ketë ndikim në marrjen e masës disiplinore ndaj saj.

5.2.6. Për pasurinë, automjet tip “Nissan”, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit mbi pamundësinë financiare, në vlerën (-) 235.207 lekë, për blerjen e tij nga bashkëshorti, në datën 03.02.2007, duke pretenduar se në kushtet e një ekonomie të përbashkët familjare me prindërit, në momente të caktuara janë përdorur edhe kursimet e tyre, në konsideratë të të cilave, subjekti dhe familja e saj do të rezultonte me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

5.2.7. Lidhur me paraqitjen e vlerës 9.968.097 lekë, në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, në pasqyrat financiare të shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka provuar bindshëm faktin se ky zë është gabim, vërtetuar edhe nga akti i ekspertimit kontabël, i paraqitur nga audituesja ligjore e shoqërisë.

5.2.8. Për analizën financiare të periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se pas korrigjimit të saj, në konsideratë të shkaqeve të ankimit, do të rezultonte një diferencë negative, në kushtet e proporcionalitetit, pa ndikim në drejtim të marrjes së masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

5.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, si dhe vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit mbi gjetjet e konstatuara nga: (i) të dhënat e raportit për analizimin e aftësive profesionale, hartuar nga KLGj-ja; (ii) kërkesat për masa disiplinore dhe ankesat ndaj subjektit të rivlerësimit; (iii) indiciet nga informacionet e marra nga mediat *online*; si dhe (iv) vlerësimi i denoncimeve. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit pretendon se konkluzionet e Komisionit për këtë kriter kundërshtojnë njëri-tjetrin, pasi nga njëra anë Komisioni deklaron se subjekti është i aftë dhe nga ana tjetër deklaron se mangësitë e konstatuara nuk riparohen nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës, kriter i cili lidhet vetëm me kriterin e aftësive profesionale dhe jo me dy kriteret e tjera, përcaktuar qartë në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në funksion të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit, ka paraqitur këto akte:

6.1.1 Mandat arkëtimi, datë 17.09.2006, depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, përmes të cilit synon të provojë se pagesa e dakordësuar nga nëna e subjektit për shitjen e truallit, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2007, në fakt, është kryer në shtator të vitit 2006⁵.

⁵ Paraqitur në Kolegj.fotokopje e noterizuar.

6.1.2 Kontratë porosie, datë 14.03.2017, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit, për blerjen e pasurisë *automjet*, tip “Opel Insignia”, faturë tatimore shitje, lëshuar nga kjo shoqëri, si dhe nxjerrje llogarie nga Banka Kombëtare Tregtare ShA, për muajin prill 2017, me anë të së cilës subjekti synon të provojë procedurat e ndjekura nga shoqëria koncesionare, në drejtim të shlyerjes së pagesave pjesore, para dhe pas dorëzimit të automjetit.

6.1.3 Format i raportimit standard 3-mujor, mbi ngarkesën e çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën tetor – dhjetor 2020; tetor – dhjetor 2021, si dhe prill – qershor 2023, bazuar në vendimin e KLGj-së nr. {***}, datë 07.02.2019.

7. Subjekti i rivlerësimit, më datë 27.10.2025, para zhvillimit të seancës gjyqësore, së bashku me parashtrimet me shkrim, ka paraqitur akte shkresore, që kanë të bëjnë: (i) me praktikat e ndjekura nga trupa gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për raste procedurale të ngjashme me ato të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit;⁶ (ii) raporte tremujore mbi ngarkesën në punë dhe vonesat⁷, si dhe projektligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Herila Çela, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Subjekti ka paraqitur: (i) Vendimin nr. {***}, datë 18.06.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjyqtare E. M.; (ii) Vendimin nr. {***}, datë 21.06.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjyqtare M. M. dhe (iii) Vendimin nr. {***}, datë 11.09.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjyqtare E. H.

⁷ Shkresë nr. prot. {***}, datë 06.04.2020, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë; Raporti tremujor janar – mars 2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Shkresë nr. prot. {***} prot., datë 03.07.2020, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë; Raporti tremujor prill – qershor 2020; Tetor – dhjetor 2021; Tetor – dhjetor 2022; Prill – qershor 2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Shkresë nr. prot. {***}, datë 04.04.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, “Dërgim informacioni” drejtuar KLGj-së; Shkresë nr. {***} prot., datë 03.12.2018, “Informacion në lidhje me dosjet e dorëzuara me vonesë për periudhën nëntor 2018, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Shkresë nr. {***} prot., datë 03.07.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe “Shkrese përcjellëse” drejtuar KLGj-së.

ii. Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi, mbi bazë aktesh të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi.
11. Në fillim të seancës gjyqësore, trupi gjykues mori në analizë shkaqet procedurale të ankimit për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale, në kuadër të cenimit të procesit të rregullt ligjor të kryer në Komision apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të legjitimonin shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore publike.

11.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ndaj saj është zhvilluar një proces në *shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së; shkelje e së të drejtës për siguri juridike për mosrespektimin e jurisprudencës të Komisionit dhe të Kolegjit, për çështje me rëndësi vendimtare për subjektin; shkelje të parimit të ligjshmërisë për shkak të ekzistencës të gjykimeve të kundërta dhe, si rrjedhojë, shkelje të nenit 8, për respektimin e jetës private nga Komisioni*. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka dhënë arsye bindëse për largimin nga praktikat e mëparshme gjyqësore, duke aplikuar standard të dyfishtë dhe cenuar besimin e publikut në këtë proces. Ndonëse subjekti pranon se jurisprudenca nuk është statike, pretendon se çdo shmangie nga qëndrimet e mëparshme të gjykatës duhet të jetë e mirëarsyetuar dhe, në rastin e subjektit, Komisioni nuk ka paraqitur asnjë arsyetim se përse nuk i ka zbatuar parimet e konsoliduara në jurisprudencën e rivlerësimit, duke arritur në konkluzione të ndryshme nga vendimmarrja e Kolegjit. Për më tepër, ndryshe nga vendimet e dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Komisioni, për shkak të numrit të kufizuar të anëtarëve të saj, ka shumë të ngjarë që të paktën disa nga gjyqtarët e ulur në panele të ndryshme të jenë pothuajse gjithmonë të njëjtët.

Shmangien e Komisionit nga jurisprudenca e tij dhe e Kolegjit, subjekti e pretendon lidhur me: (a) përfshirjen në analizë financiare të kursimeve të prindërve, të cilët nuk kanë qenë subjekt deklarues para miratimit të ligjit nr. 84/2016⁸; (b) përfshirjen në analizë financiare si të ardhura të ligjshme të të ardhurave, të cilat, edhe pse nuk janë deklaruar, rezultojnë të vërtetuara; (c) pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike të interesave vjetorë të pashoqëruara me pamjaftueshmëri financiare; (d) interpretimin dhe qëndrimin e mbajtur për shmangien e konfliktit të interesit në rastet e lidhjes së

⁸ Subjekti në shkaqet e ankimit, sa i përket trajtimit të kursimeve të prindërve që nuk kanë qenë subjekte deklaruese, referon vendimin nr. 185, datë 23.07.2019, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit O. Ç. dhe vendimin nr. 327, datë 23.12.2020 – V. V. dhe vendimet e Kolegjit nr. 26/2023 (JR) – G. Xh.; nr. 20/2023 (JR) – B. M.

kontratave me institucionet publike nga personat e lidhur; si dhe (e) interpretimin dhe qëndrimin e konsoliduar për shkakun e shkarkimit nga detyra, “Cenim i besimit të publikut”.

11.1.1. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të ligjshmërisë, për shkak të ekzistencës të gjykimeve të kundërta, thekson se vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, si e vetmja gjykatë e këtij procesi, e cila garanton ruajtjen e trajtimit të barabartë të subjekteve, qoftë për shkak të ushtrimit të funksioneve të tij gjyqësore, ashtu edhe për shkak të kompozimit të tij, çka adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës.⁹ Për më tepër, një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për ta konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi, qëndrim ky tashmë i konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit. Në këto kushte, pretendimet e mësipërme, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, do të vlerësohen nën dritën e rrethanave konkrete dhe provave të administruara për çështjen. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk argumenton pretendimet e saj lidhur me cenimin e respektimit të jetës private, duke i lënë ato në nivel deklarativ. Nga kontrolli i vendimit dhe i procedurës së ndjekur nga Komisioni, sipas përcaktimeve të nenit 8 të KEDNj-së¹⁰ dhe arsytimit të GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, trupi gjykues konstaton se hetimi administrativ i kryer për subjektin nuk paraqet ndërhyrje në jetën private, familjare apo profesionale të subjektit të rivlerësimit.

11.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në themel të vendimit janë vendosur fakte dhe shkaqe, me ndikim në vendimmarrjen e Komisionit, për të cilat nuk i ka kaluar barra e provës. Mospërmblidhja e këtij detyrimi përbën shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, për shkak të mosrespektimit të procesit të rregullt ligjor. Ky moment procedural mjaft i rëndësishëm duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërsëdrejti subjektit të rivlerësimit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj këtyre “gjetjeve/akuzave”, që prezumojnë shkarkimin nga detyra. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk e ka njoftuar se gjetjet mund të trajtohen në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe mund të çojnë në marrjen e masës disiplinore sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji. Në disa raste, konkluzioni i Komisionit në vendim s’ka asnjë lidhje me njoftimet gjatë rezultateve të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces disiplinor, në fund të të cilit mund të vendoset ose jo masë disiplinore, por të gjitha parimet e përcaktuara në nenin 100 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, flasin për parime të një procesi penal, si parimi i prezumimit të pafajësisë dhe parimi i dyshimit në favor të magjistratit. Referuar parashikimeve të nenit 42 dhe 175 të Kushtetutës, e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet as në procesin e jashtëzakonshëm të rivlerësimit.

11.2.1. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i aktit “Relacion mbi rezultatet e hetimit kryesisht për të

⁹ *Shih Beian v. Romania (no. 1)*, §§ 37 dhe 39; *Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC]*, §§ 116-35.

¹⁰ “(1) Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. (2) Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

tri kriteret e rivlerësimit”, së pari, konstaton se në këtë akt janë evidentuar të gjitha provat e administruara, shpjegimet e subjektit, si dhe janë paraqitur qartë të gjitha konstatimet, për të cilat, në bazë të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës. Dispozitat e kuadrit ligjor të rivlerësimit nuk parashikojnë detyrimin që Komisioni, në këtë akt procedural, të shprehet literalisht lidhur me prezumimin e masës disiplinore, për më tepër, në kushtet kur subjektet e rivlerësimit, me formimin e tyre profesional, kanë aftësitë për të vlerësuar peshën e konstatimit në raport me parashikimet e ligjit nr. 84/2016. Qëndrimi i Komisionit, lidhur me kualifikimin ligjor të kriterit përkatës apo vlerësimit tërësor të çështjes, është ai që deklarohet si i tillë në vendimin përfundimtar, ndaj të cilit subjekti i rivlerësimit ka të drejtën e ankimit pranë Kolegjit. Sa i përket pretendimit të subjektit se: *në disa raste, konkluzioni i shprehur, në vendimin e shumicës në Komision, s’ka asnjë lidhje me njoftimet gjatë rezultateve të hetimit, mbetet në nivel deklarativ, i paqartësuar në referime konkrete. Së dyti, trupi gjykues vlerëson se në procesin e rivlerësimit kalimtar, shkarkimi i magjistratit nga detyra është një sanksion kushtetues me natyrë disiplinore dhe jopenale. Parimet, rregullat dhe metodologjia në të cilat bazohet ky proces normohen në detaje nga ligji nr. 84/2016.*

11.3. Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “d”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar, duke i përqendruar pretendimet e saj në interpretimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe përcaktimeve të tij në parashikimet e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, qëllimi i vlerësimit të kriterit të pasurisë në këtë proces është në drejtim të evidentimit të subjekteve, të cilët nuk kanë deklaruar sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe posedojnë ose kanë në përdorim pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë që shpjegohet në mënyrë të ligjshme, sipas nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin e subjektit, përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës duhet t’iu nënshtrohen një interpretimi të rreptë, pasi parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund t’iu jepet një kuptim, i cili shkon përtej përcaktimeve të tij.

11.3.1. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje jurisprudencën e tij¹¹, në të cilën janë interpretuar, gjerësisht dhe në mënyrë konstante, parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Secili prej paragrafëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, të lidhur me rrethanat sipas të cilave prezumohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Secila nga këto rrethana është analizuar në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Më konkretisht, parashikimet kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, mbi kontrollin e kryer mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimit të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollit të ligjshmërisë së krijimit të këtyre pasurive, materializohen me përcaktimin konkret të shkeljes, në ligjin nr. 84/2016, në parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, si dhe në masat disiplinore të parashikuara në nenin 61, pikat 1 dhe 3 të tij, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e deklarimit të pasurisë, duke prodhuar masa disiplinore të veçuara nga njëra-tjetra.

11.4. Subjekti i rivlerësimit i konsideron në tejkalim të kompetencës së organeve kushtetuese të

¹¹ *Shih ndër të tjera vendimet nr. 12/2018 (JR); nr. 10/2019 (JR); nr. 21/2020 (JR); nr. 35/2020 (JR); nr. 19/2021 (JR); nr. 34/2021 (JR) dhe nr. 12/2022 (JR), të Kolegjit.*

rivlerësimit, kufij të e shtrirjes së vlerësimit të aftësive profesionale nga Komisioni, duke pretenduar se vetëm organet e reja të krijuara në kuadër të reformës në drejtësi kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha ankesat apo pretendimet për veprimtarinë profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve, jashtë procesit të rivlerësimit, sipas procedurës normale, gjatë së cilës magjistratët gëzojnë të gjitha të drejtat procedurale në mënyrë të pakufizuar. Kompetenca e gjykatës për të marrë në shqyrtim çështjet është element i procesit të rregullt ligjor, në lidhje me aspektin e gjykatës të caktuar me ligj, marrë në mbrojtje nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës.

11.4.1. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit ka marrë përgjigje në jurisprudencën e ndjekur tashmë nga Kolegji. Referuar parashikimit në pikën 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët përfshin *aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional bazuar në standardet e parashikuara në ligj*, për të vijuar me parashikimin e nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve i merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit.* Në të njëjtën logjikë vijon më pas dhe parashikimi në pikën 1, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, që lidhet me denoncimet e publikut, sipas të cilit: *çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim.* Si rrjedhojë, bazuar në këto parashikime ligjore, me qëllim për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të kriterit të aftësive profesionale, organet e rivlerësimit, pa u kufizuar në kohë, kur është e mundur dhe e nevojshme, administrojnë të gjitha burimet dhe vlerësojnë të gjitha gjetjet, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë denoncimit të fakteve nga publiku, të cilat nuk mund të mbeten jashtë procesit të rivlerësimit dhe të mos konsiderohen si burime vlerësimi, në një proces, që qëllimin kryesor të tij ka pikërisht rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

11.4.2. Trupi gjykues i Kolegjit, përpara se të çelë shqyrtimin gjyqësor të çështjes, lidhur me formën e gjykimit, analizoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve. Trupi gjykues vlerësoi se aktet bashkëlidhur ankimit nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012,¹² “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), i ndryshuar, pasi subjekti nuk provoi se, pa fajin e saj, nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Komision, në afatet e parashikuara në këtë ligj. Lidhur me aktet bashkëlidhur parashtrimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje kërkesat e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012¹³, i cili nuk parashikon mundësinë e subjekteve për paraqitjen e akteve të reja, por vetëm parashtrime me shkrim mbi shkaqet e ankimit.

¹² Ligji nr. 49/2012, në nenin 49, pika 2, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

¹³ Ligji nr. 49/2012, në nenin 49, pika 2, parashikon: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se fakti për të cilën pretendohet të provohet në favor të subjektit të rivlerësimit, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit, kështu që, në mënyrë unanime, vendosi që këto akte të mos administrohen në cilësinë e provës në Kolegj.

11.4.3. Në përfundim, për sa analizuar më sipër, trupi gjykues nuk evidentoi situata ligjore dhe procedurale të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do të sillnin nevojën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, si dhe vendosi të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49, paragrafi 1 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Herila Çela.

B. Vlerësimi i trupit gjykues për kriterin e pasurisë

Lidhur me dy depozitat në ish-Bankën Societe Generale Albania ShA (sot, OTP Bank ShA), në vlerën 944.735 lekë dhe vlerën 630.507 lekë

12. Komisioni, në vendim ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.000.000 lekë, për krijimin e depozitave pranë OTP Bank, në vitin 2006, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
13. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, pretendon se si burim krijimi për këto depozita kanë shërbyer kursimet e prindërve të subjektit, si dhe arkëtimi i shumës 1.000.000 lekë, nga shitja e truallit në pronësi të nënës, shumë e cila është arkëtuar para lidhjes së kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2007, pas Vendimit për Njohjen e të Drejtës së Pronësisë për Kthimin dhe/ose Kompensimin e Pronës nr. {***} prot., datë 02.08.2006. Gjatë hetimit u provua se nëna e subjektit është dakordësuar me palën blerëse për shitjen e truallit, kohë përpara se të nënshkruhej kontrata e shitblerjes, duke arsyetuar se nuk ka logjikë ekonomike që çmimi i shitjes së pjesës së truallit, në mars 2007, të ishte në vlerën 1.000.000 lekë. Subjekti pretendon se ka deklaruar si burim krijimi të depozitave, në deklaratën e pasurisë *vetting*, “dhuratë nga prindërit”, duke iu referuar të ardhurave nga shitja e tokës, pasi prindërit përveç pensionit, nuk kanë pasur burim tjetër të ardhurash. Lidhur me mandatarëkimin nr. {***}, datë 17.09.2006, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë hetimit në Komision ka shpjeguar se ky mandat u kërkua dhe u gjet prej saj, pasi mori dijeni nga pala blerëse, se në momentin e dhënies së parave ishte mbajtur një dokument me shkrim dore, pretendime të cilat i mbështet dhe në deklaratën noteriale të paraqitur nga njëri nga blerësit, si dhe faktin që në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, vlera e kësaj toke, për shkak të ndërtimeve, ishte rritur ndjeshëm.

13.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur për qëllim justifikimin e krijimit të depozitave me të ardhurat e prindërve, pasi mund të kishte gjetur burime të ndërmjetme, të cilat do të ishin përdorur brenda intervalit 3-ditor, mes momentit të krijimit të tyre dhe tërheqjeve të kryera nga bashkëshorti pranë Raiffeisen Bank, me qëllim për t'i rikthyer prindërve shumat e dhëna. Bashkëshorti i subjektit në këtë kohë ka pasur të regjistruar aktivitetin në shoqërinë “{***}” ShPK dhe mund të përdornin lehtësisht

fondet e shoqërisë. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, se likuidimi i çmimit të truallit është bërë në muajin shtator, pra rreth 4 muaj para se vetë nëna e subjektit të bëhej pronare dhe kjo pasuri të regjistrohej në emrin e saj, duke vlerësuar se ky argument është i pabazuar, sepse regjistrimi i pasurisë nuk është momenti i fitimit të pronësisë.¹⁴

14. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit si dhe pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

14.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) *Depozitë në Societe Generale (ish-Banka Popullore)*, çelur më datë 29.09.2006, me nr. {***}, vlera 944.735,05 lekë, pjesa takuese 100%; (ii) *Depozitë në Societe Generale (ish-Banka Popullore)*, çelur më datë 29.09.2006, me nr. {***}, vlera 630.507,13 lekë, pjesa takuese 100%. *Burimi i krijimit: Dhuratë nga prindërit (kursime të tyre) dhe interesat bankare në vite.* Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti ka paraqitur: (i) *Lëvizjet e llogarisë së depozitës nr. {***}, për periudhën 01.01.2004 – 24.01.2017, në emër të Herila Çela, me gjendje në vlerën 944.735 lekë, si dhe (ii) Nxjerrje llogarie bankare Societe Generale Albania, datë 24.01.2017, në emër të Herila Çela, me gjendje në vlerën 630.507 lekë.*

14.2. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në Banka e Kursimeve Vlorë, “me vlerë 0.5 mil”. Burimi i krijimit “dhuratë për martesë nga prindërit”.

14.3. Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim “DIPV”) - 2006, subjekti ka deklaruar depozitë bankare e vitit të kaluar në Raiffeisen Bank, transferuar në Banka Popullore, me gjithë interesat e përfituara, përkatësisht: (i) nr. depozite {***}, në shumën 600.000 lekë; (ii) nr. {***}, në shumën 600.000 lekë. Pjesa takuese 50%.

14.4. Në DIPV-2016, subjekti ka deklaruar: (i) depozitë në Societe Generale me nr. {***}, pakësuar 300.000 lekë, gjendja në datën 31.12.2016 është 630.507 lekë; (ii) depozitë në Societe Generale me nr. {***}, shtuar me 16.760 lekë, gjendja e depozitës në datën 31.12.2016 është 944.734 lekë.

14.5. Nga aktet e përcjella nga OTP Bank¹⁵ rezulton se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, pranë kësaj banke, në datën 29.09.2006, është kryer një depozitim me vlerë 1.200.000 lekë, me përshkrim: “Derdhje cash Th. L.”. Në të njëjtën datë, në llogarinë e subjektit, nga ky depozitim janë krijuar dy depozita, secila me vlerë 600.000 lekë.

14.6. Sa rezultat më sipër, Komisioni, në pyetësorin shtesë nr.1, datë 03.07.2023, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë burimin e vlerës prej 1.200.000 lekësh, si dhe të paraqesë dokumentacion

¹⁴ Subjekti referon Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 06.01.2009: “Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek te tretët. Kontrata, e cila nuk është e regjistruar, është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve”.

¹⁵ Shkresë nr. {***}, datë 18.02.2021, nga OPT Bank (ish-Banka Popullore, më pas Societe Generale).

ligjor lidhur me dhurimet/kursimet e prindërve, të deklaruara si burim për krijimin e depozitave në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se shuma prej 1.200.000 lekësh i është dhuruar nga e ëma, për të krijuar dy depozita në emër të vajzave të saj (subjektit), përkatësisht me nga 600.000 lekë secila. Kursimet e nënës kanë si burim vlerën 1.000.000 lekë nga shitja e tokës truall, me sipërfaqe 2 680 m², sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2007. Subjekti shpjegoi se transaksioni i blerjes ishte kryer kohë më parë, por kontrata është nënshkruar në muajin mars 2007, pas regjistrimit të tokës në datën 08.01.2007 dhe lëshimit të certifikatës së pronësisë në datën 11.01.2007. Likuidimi i shitjes së tokës ishte kryer nga blerësit në *cash* ose gjatë vitit 2005, ose në fillim të vitit 2006 dhe verbalisht palët kanë rënë dakord si për çmimin, ashtu dhe për sipërfaqen që do të blinin, në pamundësi për të nënshkruar kontratën. Përveç të ardhurave nga shitja e tokës, prindërit kanë pasur kursime familjare të krijuara nga interesat bankare të depozitave. Gjithashtu, prindërit gjatë kohës së fillimit të bashkëjetesës me subjektin (korrik 2005 e në vazhdim), kanë kursyer një pjesë të pensioneve, pasi shpenzimet mbuloheshin nga ajo dhe bashkëshorti. Subjekti shpjegoi se nuk pranoi t'i mbante kursimet/dhurimet e nënës dhe, për këtë arsye, tri ditë më vonë tërhoqi depozitat pranë Raiffeisen Bank¹⁶ dhe ia ktheu ato.

14.7. Në konsideratë të faktit se kontrata e shitblerjes së truallit është nënshkruar nga nëna e subjektit në datën 21.03.2007, ndërsa depozitimi në llogarinë e subjektit në OTP Bank është kryer nga bashkëshorti, në datën 29.09.2006, si dhe faktit se deklarimi i subjektit, se vlera prej 1.000.000 lekë është arkëtuar në fund të vitit 2005 dhe/ose në fillim të vitit 2006, mbeti në nivel deklarativ, Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë shumë si burim për depozitimin prej 1.200.000 lekësh, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën 1.000.000 lekë, për krijimin e depozitave pranë OTP Bank.

14.8. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, sikurse dhe në pyetësin shtesë nr. 1, ka deklaruar se si burim krijimi për depozitimin prej 1.200.000 lekësh kanë shërbyer kursimet e prindërve, si dhe arkëtimi i vlerës 1.000.000 lekë, nga shitja e tokës, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2007, me palë blerëse L. N. dhe P. Ç. Në kontratë është përcaktuar se vlera 1.000.000 lekë është paguar 500.000 lekë nga secili dhe likuidimin palët në kontratë e kanë kryer jashtë zyrës noteriale të noteres. Pala blerëse ka qenë e interesuar të paguajë sa më herët të ishte e mundur vlerën prej 1.000.000 lekësh. Në momentin kur nëna subjektit kishte dakordësuar me ta për blerjen e një pjese të truallit, interesat në zonë nuk ishin shumë të mëdha dhe sapo kishte filluar të ndërtohej. Subjekti ka shpjeguar se regjistrimi i tokës në emër të nënës është kryer në datën 08.01.2007, duke i dhënë mundësi blerësve të lidhnin kontratën dy muaj më vonë, në datën 21.03.2007, pasi njohja e tokës mori kohë, nga qershori i vitit 2003 (vendim nr. {***}, datë 30.06.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) deri në momentin e regjistrimit, janar 2007. Gjatë komunikimit verbal me blerësin, L. N., subjekti është informuar se ndërmjet tyre ishte firmosur dhe mandat arkëtimi me 3 dublikata, ku secili prej blerësve ishte pajisur me një kopje. Pasi ka kërkuar në arkivin ku nëna ka mbajtur të gjithë dokumentacionin e pronësisë, ka gjetur kopje të mandatarëkëtit nr. {***}, datë 17.09.2006, për pagesën e tokës, me përshkrimin: “Arkëtim nga shitja e truallit me sipërfaqe 938m,² në vlerën 1.000.000 lekë”. Në funksion

¹⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 16.02.2021.

të prapësimeve, subjekti ka paraqitur: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.07.2023, të blerësit L. N., i cili deklaroi se ka paguar bashkë me P. Ç. respektivisht 500.000 lekë për blerjen e pasurisë së llojit “truall” jashtë zyrës noteriale, rreth 6 muaj para nënshkrimit të kontratës, pasi njiheshin dhe kishin besim reciprok, si dhe (ii) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 17.09.2006.

14.9. Komisioni nuk i ka gjetur bindëse shpjegimet e subjektit, se likuidimi i çmimit të truallit është bërë në muajin shtator, pra rreth 4 muaj para se vetë nëna e subjektit të bëhej pronare dhe kjo pasuri të regjistrohej në emrin e saj. Lidhur me mandatarëkimin nr. {***}, datë 17.9.2006, Komisioni arsyetoi se ky mandat i paraqitur në këtë fazë të procesit nuk provon dhe nuk mund të shërbejë si provë, pasi: (i) nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, ky mandat është fotokopje dhe jo dokument origjinal ose i njësuar; (ii) ky mandat nuk u paraqit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, çka e bën jo të besueshëm në këtë fazë ekzistencën e një dokumenti të mbajtur me shkrim dore, i cili nuk është në harmoni me provat e tjera dhe mund të hartohet në çdo kohë, duke mos e krijuar në këtë mënyrë bindjen se është përpiluar në kohën e pretenduar; si dhe (iii) nuk bindin deklaratimet e subjektit, se nuk mund të pranonte të mbante kursimet e nënës, pasi këto kursime u pretenduan gjatë hetimit dhe si burim për depozitat e krijuara në vitin 2010, ndërkohë që të ardhurat nga qiradhënia/shitja e pasurive të paluajtshme – të cilat, sipas deklaratimit të përfaqësues ligjore të subjektit, në seancë dëgjimore, u pretenduan si burim i tyre – filluan rreth dy vite më vonë (në vitin 2012). Në konkluzion, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.000.000 lekë, për krijimin e depozitave pranë OTP Bank, në vitin 2006, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

14.10. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të akteve në dosje gjyqësore të Komisionit, lidhur me burimin e pretenduar nga subjekti, si rezultat i transaksionit të shitjes së truallit prej 2 680 m², nga nëna e subjektit, vëren se:

14.10.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 30.06.2003, ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së kërkuësës E. Ç., nënës së subjektit, për një sipërfaqe truall prej 8 200 m², që ndodhet në {***}, Vlorë, si dhe rivendosjen e kërkuësës në afat për të paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim “KKKP”) Vlorë¹⁷. Në vijim, referuar ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me vendimin e datës 02.08.2006, i ka njohur E. Ç. të drejtën e pronësisë për sipërfaqen e shpronësuar prej 8.200 m² truall, nga e cila i është kthyer fizikisht një sipërfaqe prej 2 680 m², dhe kompensuar sipërfaqja e mbetur prej 5 520 m². Ky vendim, administrativisht, ka marrë formë të prerë më datë 05.10.2006, ndërkohë që mandati i thjeshtë me shkrim dore, i paraqitur nga subjekti në përgjigje të barrës së provës, daton më herët në kohë, më datë 17.09.2006.

¹⁷ Referuar ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, në nenin 22 të tij, parashikohet se: “Veprimet për njohjen e pronësisë sipas dispozitave të këtij ligji bëhen nga organet e ngarkuara për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në bazë të dokumenteve zyrtare, që do të paraqesin ish-pronarët e tyre. Në mungesë të tyre, pronësia vërtetohet me vendim gjyqësor në prani të palës kundërshtare. Kërkesa për fitimin e pronësisë mund të paraqitet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se personi ish-pronar për shkaqe të përligjura, nuk ka marrë dënim, ka të drejtë të rivendosë afatin nëpërmjet gjykatës”.

14.10.2. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuria “truall” me sipërfaqe 2 680 m² rezulton të jetë regjistruar në emër të nënës së subjektit, në datën 08.01.2007. Më pas, më datë 21.03.2007, është lidhur kontrata noteriale e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., përmes së cilës nëna e subjektit të rivlerësimit e ka shitur këtë sipërfaqe trualli, në vlerën 1.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale, pa përcaktuar kohën e saktë të këtij likuidimi, e aq më pak nuk mbështet pretendimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit shtesë nr.1, se likuidimi ishte kryer nga blerësit në *cash*, ose gjatë vitit 2005, ose në fillim të vitit 2006.

14.10.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.07.2023, të blerësit L. N., i cili deklaroi se ka paguar bashkë me P. Ç., vlerën e pasurisë rreth 6 muaj para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Përmbajtja e kësaj deklaratë, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, merret me rezervë në këtë proces, pasi është përpiluar gjatë dhe për shkak të tij, dhe në rastin konkret, nuk mbështetet nga provat e administruara në dosje të Komisionit. Po ashtu dhe mandati i thjeshtë, me shkrim dore, i paraqitur nga subjekti vetëm në përgjigje të barrës së provës, nuk gjen referencë në provat e tjera të administruara.

14.10.4. Në drejtim të përcaktimit të datës së likuidimit të çmimit sipas kontratës së shitblerjes të vitit 2007, trupi gjykues vlerëson se mbeten pa peshë përcaktuese dhe në nivel deklarativ pretendimet e subjektit: (i) lidhur me vlerën e rritur të truallit, në momentin e lidhjes së kësaj kontrate; (ii) faktit që subjekti kishte mundësi nga biznesi i bashkëshortit të siguronte të ardhurat për burimin e depozitës, për sa kohë burimi i deklaruar nga vetë subjekti, për depozitimet ka qenë “dhuratë nga prindërit”, si dhe (iii) pretendimet se vetëm pasi ndërroi jetë nëna, në vitin 2010, subjekti administronte së bashku me babain të gjitha kursimet familjare.

14.10.5. Në këto rrethana, në kushtet kur aktet në dosje nuk mbështesin pretendimin e subjektit, se likuidimi i çmimit është kryer më datë 17.09.2006, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përfituara prej nënës, nga shitja e tokës, në vlerën 1.000.000 lekë, me kontratën e shitjes të datës 21.03.2007, nuk provohen të kenë shërbyer si burim për depozitimet në vlerën 1.200.000 lekë, të kryer në datën 29.09.2006.

14.10.6. Në përfundim, rezulton se lidhur me dy depozitat në ish-Bankën Societe Generale Albania ShA, përkatësisht në vlerën 944.735 lekë dhe vlerën 630.507 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme, për krijimin e këtyre depozitave, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për depozitën në ish-Bankën e Kursimeve, në vlerën 539.346 lekë (sot, Raiffeisen Bank ShA)

15. Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në shumën (-) 848.073 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank ShA, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
16. Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit ka ngritur të njëjtat pretendime sikurse dhe gjatë hetimit

administrativ në Komision, ndër të tjera, duke theksuar se depozitat janë krijuar përpara emërimit të saj në detyrë. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën 1997 – 2003, subjekti pretendon të përfshihen dhe të ardhurat nga aktiviteti i personit fizik, i regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit, të cilat kanë qenë burimet kryesore të të ardhurave në vitet 2001 dhe 2002. Këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si pasojë e vështirësisë që subjekti kishte hasur në deklaram. Lidhur me këto të ardhura i është drejtuar, me kërkesë për informacion, Bashkisë Vlorë, Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, ka paraqitur formularët e Njoftim Tatimit për vitin 2001 dhe 2002, si dhe tabelën e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003, të gjendur në arkivin e dokumenteve të aktivitetit të bashkëshortit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë hetimit administrativ është vërtetuar se bashkëshorti i saj i ka paguar detyrimet tatimore për vitet 2001, 2002, 2003, në cilësinë e personit fizik dhe fitimet neto duhet të përfshihen në analizën financiare. Paralelisht me aktivitetin si person fizik, bashkëshorti i saj ka themeluar edhe shoqërinë “{***}” SHPK, nga i cili ka siguruar të ardhura të konsiderueshme. Marzhi i fitimit, për shkak të shërbimeve të ndryshme që bashkëshorti i saj ofronte nga dyqani, ka qenë tepër i lartë, rreth 50-60% të qarkullimit dhe jo 20%, sikurse është përlllogaritur nga Komisioni, i cili ka gabuar në vlerësimin e objektit të aktivitetit të personit fizik, pasi përveç tregtimit me pakicë të kancelarisë ka ofruar dhe shërbim të fotokopjeve të librave dhe materialeve të përdorura kryesisht nga studentet e Universitetit të Vlorës. Komisioni ka përdorur si referencë vendimin nr. 2/2023 të Kolegjit dhe ka llogaritur marzhin e fitimit 20% për shitjet me pakicë, ndërkohë që Kolegji, duke analizuar aktivitetin e përzier të ushtruar nga personi tjetër i lidhur, ka përcaktuar në paragrafin 18.16, se marzhi i fitimit duhet të konsiderohet 30%. Për sa më lart, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit 33, shkronja “b”, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, si dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

17.1. Nga informacioni i administruar nga Raiffeisen Bank, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë klient i ish-Bankës së Kursimeve, Dega Vlorë¹⁸. Me anë të pyetësorit shtesë nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të specifikojë datën, dinamikën dhe burimin financiar të krijimit të depozitave, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues.

17.2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij pyetësori, shpjegoi se llogaria me nr. {***}, me tepricë, në datën 30.09.2004, në vlerën prej 539.346 lekësh, ka si burim *kursimet e depozituara ndër vite*.

¹⁸ Nga hetimi administrativ, bazuar në informacionin e administruar nga Raiffeisen Bank (Shkresa nr. {***} prot., datë 16.02.2021), në emër të subjektit të rivlerësimit, Komisioni konstatoi dy llogari bankare: (i) nr. {***}, çelur në datën 30.09.2004, e cila derivon nga depozita e krijuar në datën 09.07.2003, në shumën 500.000 lekë, e maturuar dhe shtuar me interesa bankarë, me një vlerë prej 535.948 lekësh dhe (ii) llogaria nr. {***}, çelur në datën 30.09.2004, me një vlerë 539.346 lekë. Komisioni, lidhur me depozitën bankare, në vlerën 500.000 lekë, të krijuar në datën 09.07.2003, ka vlerësuar të marrë në konsideratë të ardhurat e pretenduara nga subjekti si burim për krijimin e saj (dhuratë martesë nga prindërit dhe familjarët e tjerë), duke dalë në konkluzionin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e saj. Diferenca negative e konstatuar për krijimin e kësaj depozite, pas përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në masën 30 %, për vitin 1999, është reduktuar nga Komisioni në një vlerë jo të konsiderueshme prej (-)18.740 lekësh. Në këto kushte, trupi gjykues do të ndalet në vijim mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionet e Komisionit për depozitën bankare nr. {***}.

Subjekti paraqiti shkresën nr. {***} prot., datë 06.07.2023, të Raiffeisen Bank, e cila, në përgjigje të kërkesës së subjektit, ka përcjellë kopje të dokumenteve të gjetura në arkiv, që i përkasin inventarit të vitit 1999 dhe 2001, në emër të subjektit, nga ku rezulton se kjo depozitë është shtuar gjatë vitit 2002 dhe 2003. Për herë të parë në këtë depozitë është depozituar, në datën 31.12.1999, vlera 20.000 lekë.

17.3. Komisioni, për efekt të kryerjes së analizës financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme, përcaktoi kohën e krijimit të depozitës, referuar dinamikave të lëvizjeve, konkretisht: (i) shtesë depozite në ish-Bankën e Kursimeve, në vlerën 20.000 lekë, në datën 31.12.1999¹⁹; (ii) interesa të fituara në vlerën 1.858 lekë dhe në të njëjtën vlerë edhe shtesë depozite, në datën 31.12.2001²⁰; (iii) interesa të përlllogaritur për periudhën 2002 – 2003, në vlerën 39.346 lekë²¹; (iv) shtesë depozite në ish-Bankën e Kursimeve, në vlerën 517.488 lekë²². Rezultatet e analizës financiare treguan një balancë negative në vlerën (-) 1.318.906 lekë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzime për periudhën 1997 – 2003, duke i kaluar subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën.

17.4. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, pretendoi se Komisioni në analizën financiare të kryer për periudhën 1997 – 2003 nuk ka përfshirë të ardhurat nga aktiviteti i personit fizik, i regjistruar në emër të bashkëshortit. Bashkëshorti është regjistruar si person fizik në datën 30.10.2001, me objekt aktiviteti “Tregtim i mallrave të ndryshëm në fushën e kancelarisë e pajisjeve të zyrës”. Në datën 01.11.2001 është lëshuar *Fletë Njoftim Tatimi*, nëpërmjet të cilit bashkëshorti ka paguar 15.000 lekë. Për vitin 2002 është lëshuar *Fletë Njoftim Tatimi*, i datës 29.03.2002, nëpërmjet të cilit është paguar vlera 40.000 lekë. Përveç formularëve të *Njoftim Tatimit* për vitin 2001 dhe 2002, në arkivin e dokumenteve, në atë periudhë, bashkëshorti ka gjetur dhe tabelën e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003. Në këtë formular është deklaruar xhiro për vitin 2003, në shumën 3.000.000 lekë dhe tatimi i paguar 120.000 lekë. Për efekt të procesit të rivlerësimit i është drejtuar me kërkesë Bashkisë Vlorë, e cila ka informuar se për personin fizik me kod fiskal {***}, i regjistruar me aktivitet “shitje kancelari”, nuk rezulton asnjë e dhënë në regjistrat e taksapaguesve në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, Bashkia Vlorë. Gjithashtu edhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., datë 06.09.2023, informon se subjekti Th. N. L., me kod fiskal {***}, ka kryer pagesat për detyrimet dhe për periudhat tatimore që ka qenë aktiv, nuk disponojmë dosje fizike, si rrjedhojë, nuk disponojmë kërkesë për çregjistrim për vitet 2002 – 2004, as vendim gjykate për mbyllje dhe certifikatë regjistrimi. Në lidhje me fitimin neto të realizuar, dyqani *kancelari* ka pasur marzh relativisht të lartë, pasi në fillim të këtyre viteve ka pasur një kërkesë të madhe për produktet kancelarike dhe fotokopjet. Marzhi i fitimit i realizuar nga dyqani ka qenë në masën 50-60% të qarkullimit. Subjekti ka paraqitur dhe deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.10.2023, të kontabilistit V. Xh., i cili deklaroi se një ndër subjektet që i ka mbajtur dokumentacionin financiar nga momenti i hapjes së aktivitetit dhe në vazhdim, është personi fizik Th. L., kryesisht me aktivitet *kancelari*, të cilin e ka ushtruar deri në 6-mujorin e parë të vitit 2004.

17.4.1. Subjekti i rivlerësimit pranon faktin se këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim në deklaratën

¹⁹ Konfirmuar nga Raiffeisen Bank.

²⁰ Konfirmuar nga Raiffeisen Bank.

²¹ Si diferencë midis vlerës së depozitës, prej 539.346 lekësh dhe vlerës 500.000 lekë (në mungesë të informacionit për datën e saktë të shtimit të depozitës, u përcaktuan interesa në vlerën 39.346 lekë, duke marrë si referencë vlerën e interesave për depozitën nr. {***}, për shkak të vlerave të përafërta).

²² Në mungesë të informacionit, e përlllogaritur si diferencë midis gjendjes së llogarisë prej 539.346 lekësh dhe shtesave të mëparshme (20.000 lekë dhe 1.858 lekë).

e pasurisë *vetting*, por kjo pasaktësi, në kushtet kur: (i) ushtrimi i aktivitetit; (ii) xhiroja e realizuar gjatë vitit dhe (iii) pagesa e detyrimeve tatimore u provua me prova të pakundërshtueshme, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, mbetet e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit. Këto të ardhura janë reale, të matshme me metoda alternative dhe plotësojnë kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në përfundim, subjekti paraqiti analizën financiare për periudhën 1997 – 2003, me një balancë negative në shumën 268.906 lekë, analizë në të cilën evidentohet një fitim në masën 150.000 lekë për vitin 2001, në masën 900.000 lekë për vitin 2002, ndërsa për vitin 2003 nuk paraqitet fitim nga ky aktivitet.

17.5. Në përfundim, lidhur me depozitën bankare nr. {***}, Komisioni konstatoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë llogari në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit subjekti mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil. Sa i përket të ardhurave të realizuara nga aktiviteti i bashkëshortit si person fizik, Komisioni vlerësoi të përfshijë në analizë financiare vetëm të ardhurat e realizuara në vitet 2001 – 2002 dhe jo për vitet 2003 – 2004, duke arsyetuar se: (i) Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti si person fizik, në deklaratën e pasurisë së viteve 2003 dhe 2004, ndërkohë që ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti i shoqërisë “{***}” ShPK. (ii) Gjatë hetimit nuk u administrua asnjë shkresë nga organet tatimore, ku të konfirmohej zhvillimi i aktivitetit gjatë viteve 2003 dhe 2004. (iii) Në datën 28.01.2003, bashkëshorti i subjektit ka themeluar shoqërinë “{***}” ShPK, çka do të thotë që, duke filluar nga periudha janar 2003 e në vijim, bashkëshorti zhvillonte aktivitet tregtar nëpërmjet shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Në kushtet e mungesës së informacionit mbi xhiron dhe fitimin e realizuar, Komisioni përlllogariti një fitim të mundshëm, duke aplikuar një marzh fitimi në masën 20%, referuar natyrës së aktivitetit të zhvilluar dhe faktit se ky aktivitet tregtar ishte në fillesat e tij. Në përcaktimin e këtij raporti, Komisioni mbajti në konsideratë faktin se norma e fitimit prej 20% është përdorur nga Komisioni në përcaktimin e fitimit në rastet e aktivitetëve tregtarë të shitjes me pakicë të mallrave, praktikë e cila është lënë në fuqi edhe në vendimmarrjet e Kolegjit.²³ Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në shumën (-) 848.073 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

17.6. Trupi gjykues i Kolegjit, sa i përket pretendimit të subjektit se kjo depozitë është krijuar para fillimit të detyrës, vlerëson se, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit dhe legjislacionin e zbatueshëm, standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në drejtim të verifikimit të saktësisë në deklarime dhe burimeve të ligjshme të pasurive të magjistratëve, kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruara dhe nuk e kufizon atë në pasuri të krijuara para apo pas emërimit në detyrë të magjistratit. Sa sipër, trupi gjykues analizoi faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ në Komision, lidhur me mundësinë financiare të subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme depozitën objekt shqyrtimi, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

17.6.1. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar të ardhura nga pagat e përfituara si ortak i vetëm nga shoqëria “{***}” ShPK dhe nga shpërndarja e dividendit

²³ Vendim nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023, paragrafët 18.13 - 18.14 - 18.16 dhe vendim nr. 47/2022 (JR), datë 14.12.2022, paragrafi 19.12.4.

sipas bilanceve të kësaj shoqërie, por nuk ka deklaruar të ardhurat e pretenduara nga ushtrimi i aktivitetit të tij si person fizik, me objekt “Tregtim i mallrave të ndryshëm në fushën e kancelarisë e pajisjeve të zyrës”. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, edhe në përgjigje të pyetësorit shtesë nr. 1, të Komisionit, ka deklaruar si burim të depozitës “kursimet e depozituara ndër vite”, pa specifikuar burimin e të ardhurave/kursimeve.

17.6.2. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë depozitë në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, të vitit 2003, nuk rezulton i deklaruar as burimi i krijimit të saj. Në këtë deklaratë, e cila sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së Kolegjit, shërben si provë në këtë proces, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit, “*Dyqan për kancelari*”, shuma 830.000 lekë, nga të cila, shuma neto 680.000 lekë.

17.6.3. Në DIPV-2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit nga paga, sipas bilancit të vitit 2004, të shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 3.000.000 lekë.

17.6.4. Referuar shkresës me nr. {***} prot., të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, nga shoqëria “{***}” ShPK, rezulton se nga vitet 2003 – 2005, kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividendë.

17.6.5. Qendra Kombëtare e Biznesit, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 11.02.2021, ka informuar Komisionin se bashkëshorti i subjektit, Th. L., figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. {***}, datë 30.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, por nuk mund të identifikohet numër NIPT-i. Sipas vendimit të Gjykatës rezulton se është pranuar kërkesa e bashkëshortit të subjektit për hapjen e aktivitetit si person fizik, me objekt: “Tregtimin e mallrave të ndryshëm”.

17.6.6. Bashkia Vlorë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.08.2023, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për t’u informuar mbi datën e mbylljes së aktivitetit, xhiron e parashikuar, xhiron e deklaruar, kopje të fletë-ngoftimeve për tatimin dhe shumën e tatimeve të paguar, për secilin vit kalendarik, lidhur me subjektin Th. L., person fizik, ka informuar se disponon të dhëna për personat fizikë dhe juridikë prej vitit 2007 e në vazhdim.

17.6.7. Aktet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të barrës së provës, nuk paraqesin ndonjë rrethanë të re, në drejtim të provueshmërisë të realizimit të këtyre të ardhurave. Shkresa nr. {***} prot., datë 06.09.2023, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, informon se për subjektin Th. L., person fizik, janë kryer pagesat për detyrimet dhe për periudhën që ka qenë aktiv, por nuk disponojmë dosje fizike, kërkesë për çregjistrim për vitet 2002 – 2004, as vendim gjykate për mbyllje dhe as certifikatë regjistrimi. Po ashtu, Bashkia Vlorë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.07.2023, ka informuar bashkëshortin e subjektit se për këtë person fizik, me aktivitet shitje kancelari, nuk rezulton asnjë e dhënë në regjistrat e tatimpaguesve në këtë drejtori. Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.10.2023, e kontabilistit V. Xh., si deklaratë e sjellë gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, merret me rezervë në këtë proces, për më tepër kur përmbajtja e saj nuk mbështetet apo nuk është në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

17.6.8. Përmbajtja e dokumentit, fotokopje e noterizuar, “*Tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003*”, veprimtaria “*Dyqan kancelari*”,

Th. L., e pretenduar se është gjetur nga subjekti në arkivin e dokumenteve të bashkëshortit të asaj periudhe, nuk konfirmohet nga organet përgjegjëse. Referuar këtij dokumenti, taksa vendore mbi biznesin e vogël, në momentin e regjistrimit, është në shumën 18.000 lekë, ndërsa qarkullimi i deklaruar 3.000.000 lekë dhe tatimi mbi fitimin 60.000 lekë.

17.6.9. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka paraqitur dhe dy “Fletë njoftim tatimi” të biznesit të vogël, aktivitet tregti me pakicë e kancelarive nga tatimpaguesi *Th. L.*, përkatësisht i datës 01.11.2001, sipas të cilit tatimi gjithsej ka qenë në shumën 25.000 lekë, nga të cilat 20.000 lekë, për xhiro deri në 2 milionë lekë dhe 5.000 lekë, për xhiro 2-5 milionë lekë, si dhe fletë njoftim-tatimi, i datës 29.03.2002, me tatim gjithsej 40.000 lekë, për xhiro deri në 2 milionë lekë. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto dokumente japin informacion mbi nivelin e xhiros dhe tatimit të paguar për secilin nivel, por jo për xhiron reale që subjekti tregtar ka realizuar.

17.6.10. Lidhur me pretendimin e subjektit, se Komisioni duhej të kishte aplikuar normën prej 30% të fitimit, në referencë të vendimit nr. 2/2023 (JR) të Kolegjit, trupi gjykues vëren se në këtë vendim Kolegji ka aplikuar këtë normë, pasi ka vlerësuar se subjekti ka paraqitur dokumentacion, i cili paraqet një situatë të qartë se biznesi kishte zgjeruar aktivitetin e tij me shërbime të ndryshme, të cilat kanë pasur një marzh fitimi më të lartë se 20%. Në rastin e subjektit të rivlerësimit *Herila Çela*, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion, i cili të tregojë vlerën e produkteve të shitura dhe koston e blerjes së tyre. Pretendimet e subjektit, se bashkëshorti i saj, gjatë ushtrimit të aktivitetit të personit fizik, *ka ofruar dhe shërbim të fotokopjeve të librave dhe materialeve të përdorura kryesisht nga studentet e Universitetit të Vlorës*, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten nga të dhënat e akteve në dosje. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit pretendon se fitimi ka qenë rreth 50% e xhiros, por nuk paraqiti dokumentacion provues në mbështetje të këtij pretendimi, i cili mbeti në nivel deklarativ.

17.6.11. Trupi gjykues, në konsideratë të pretendimeve të subjektit, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të krijuar me të ardhura të ligjshme depozitat për periudhën 1997 – 2003, duke përllogaritur fitimin e mundshëm nga aktiviteti i bashkëshortit, si person fizik, me marzh fitimi 20%, mbi xhiron e parashikuar në fletën e njoftimit të tatimit. Nga analiza e kryer për këtë periudhë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe gjithashtu për të krijuar kursime për një diferencë negative në shumën (-) 847.954 lekë. Në funksion të një qëndrimi garantist, trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu edhe alternativën e kontrollit të analizës financiare, duke përllogaritur fitimin e mundshëm nga aktiviteti i bashkëshortit si person fizik, me marzh fitimi 30%, mbi xhiron e parashikuar në fletën e njoftimit të tatimit, por edhe në këtë alternativë, rezultatet e analizës treguan balancë negative.

17.6.12. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se për depozitën në ish-Bankën e Kursimeve, në vlerën 539.346 lekë, subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në periudhën 1997 – 2003, për krijimin e kësaj depozite, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me dy depozitat, në vlerën 2.800.000 lekë, në Intesa Sanpaolo Bank ShA, dhe në vlerën 2.776.000 lekë, në Union Bank ShA

18. Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën (-) 2.129.846 lekë, për krijimin e depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe pranë Union Bank, pasi: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.100.000 lekë, për kryerjen e depozitimit në datën 18.05.2004. (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
19. Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit pretendon se Komisioni ka njohur të ardhurat nga aktiviteti si personit fizik i bashkëshortit, në vitin 2001 dhe 2002, por nuk jep asnjë argument përse nuk i njeh të ardhurat për vitin 2003, pasi subjekti ka paraqitur të njëjtin dokumentacion për të vërtetuar ushtrimin e aktivitetit të personit fizik në të këto tri vite. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë dokumentin mbi të ardhurat e aktivitetit për vitin 2003 me argumentin se, ndryshe nga dokumentet për vitin 2001 dhe 2002, ai u soll nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit. Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti si person fizik nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, sepse nuk kishin dijeni për mënyrën e llogaritjes së fitimit dhe pasqyrimit të këtij fitimi në deklaratë. Mosdeklarimi i këtyre të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk mund të fshijë nga ekzistenca realizimin e aktivitetit nga personi fizik, krijimin e të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore, të cilat provohen tej çdo dyshimi të arsyeshem nga dokumentet zyrtare me fuqi të plotë provuese, të paraqitura në përgjigje të rezultateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar ndryshe nga jurisprudenca e Kolegjit, sa i përket vlerësimit të pasaktësisë në deklarime²⁴, si dhe sa i përket kursimeve të prindërve, të cilët nuk kanë qenë subjekte deklaruese²⁵.

19.1. Duke ngritur të njëjtat pretendime si gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit pretendon se, në vitin 2003, bashkëshorti i saj, për aktivitetin tregtar të ushtruar si person fizik, ka deklaruar një xhiro prej 3.000.000 lekësh dhe, duke llogaritur një fitim prej 50%, pasi ka zbritur detyrimet, do të rezultonte me një fitim prej 1.360.000 lekësh. Pas mbylljes së aktivitetit si person fizik, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr fitimin dhe e ka depozituar në bankë në datën 18.05.2004, e ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë të vitit 2004. Në lidhje me depozitat e krijuara në datën 15.12.2010 dhe 17.12.2010, në Union Bank, subjekti pretendon se ato janë çelur në emër të babait të saj, në vlerat 20.000 euro dhe 2.776.000 lekë, me pjesë takuese 50%. Subjekti shprehet se, përveç kursimeve *cash*, në shumën 4.200.000 lekë, për shtesat e depozitave në vitin 2010 ka shërbyer edhe shpërndarja e dividendit në shumën 540.000 lekë, i cili u destinua edhe për shtesat në llogarinë me nr. {***}, në OTP Bank dhe gjendjen e datës 31.12.2010, në shumën 339.394 lekë. Depozita e babait të subjektit të rivlerësimit ka pasur si burim kursimet e nënës së subjektit nga shitja tokës dhe kursimet e tjera të saj, në vlerën 1.200.000 lekë. Në analizën financiare duhet të përfshihen edhe kursimet *cash* të disponuara nga prindërit dhe, në këtë mënyrë, balanca e vitit 2010 do të rezultonte me diferencë pozitive në shumën 170.154 lekë.

²⁴ Duke referuar vendimin e Kolegjit nr. 38/2022 (JR), paragrafi 14.24.4 i tij.

²⁵ Duke referuar vendimin e Kolegjit nr. 20/2023 (JR), paragrafi 11.9 i tij.

20. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, si dhe pretendimeve të subjektit në ankim dhe në parashtime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

20.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se zotëron: (i) depozitë në Union Bank, vlera 2.776.000 lekë (në emër të vjehrrit A. Ç.). Pjesa takuese 100%. (ii) Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, vlera 2.800.000 lekë (në emër të vjehrrit, A. Ç.). Pjesa takuese 100%²⁶. Burimi i krijimit: të ardhurat nga emigracioni në shtetin italian, për periudhën 1992 – 1997, si dhe nga firmat piramidale.

20.2. Në analizë të deklaratimeve periodike vjetore të subjektit në ILDKPKI, si dhe nga lëvizjet në të gjitha llogaritë bankare që prej vitit 2003, deri në momentin e krijimit të tyre, rezulton kjo kronologji:

20.3. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare në emër të z. Th. L. në BKT, me vlerë 2 milionë lekë, me burim krijimi kursimet nga emigracioni në vitet '92 – '97.

Në datën 30.04.2003 është kryer një depozitim me vlerë 2.000.000 lekë në llogarinë dyemërore të babait dhe të bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së, me përshkrimin “cash deposit”. Më tej, më datë 02.05.2003, është krijuar një depozitë bankare me të njëjtën vlerë. Në datën 01.06.2009 është maturuar depozita bankare e krijuar në vitin 2003, në vlerën 2.814.608 lekë (përfshirë interesat).

20.4. Në DIPV-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare në emër të z. Th. L., me burim kursimet nga emigracioni në vitet '92 – '97.

Në datën 18.05.2004 është kryer pranë BKT-së një depozitim me vlerë 1.100.000 lekë, në llogarinë dyemërore të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, me përshkrim “cash deposit”. Më tej, më datë 19.05.2004, është krijuar një depozitë bankare me të njëjtën vlerë. Në datën 29.05.2009 është maturuar depozita bankare e krijuar në vitin 2004, në vlerën 1.419.275 lekë (përfshirë interesat). Pas maturimit, në datën 01.06.2009, pasi u kryen dy tërheqje në shumën totale prej 30.000 lekësh²⁷, vlera e mbetur, konkretisht vlera 4.203.883 lekë²⁸, u transferua në llogarinë rrjedhëse dyemërore (në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit).

20.5. Në DIPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar “Depozitë bankare në BKT, hapur më datë 30.04.2003 dhe mbyllur. Tërhequr principlali dhe interesat *cash* të bashkëshortit. E disponueshme *cash*, vlera 4.200.000 lekë”.

Nga lëvizjet e llogarive rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, më datë 09.06.2009, datë 22.06.2009, datë 25.06.2009, kreu këto tri transaksione: (i) transfertë në shumën 397.200 lekë, kundrejt L. N. për kambizëm; (ii) tërheqje në shumën 1.000.000 lekë; (iii) transfertë në shumën 2.715.300 lekë, për “{***}” ShPK, me përshkrim “blerje 21.000 euro, me kurs 129,3”. Komisioni vëren se shuma totale

²⁶ Subjekti ka bashkëlidhur: (i) Nxjerrje llogari bankare datë 25.01.2017, Intesa Sanpaolo Bank, në emër të A. Ç., me gjendje në vlerën 2.800.000 lekë; (ii) nxjerrje e llogarisë bankare, datë 25.01.2017, Union Bank, në depozitën në emër të A. Ç., me gjendje në vlerën 2.770.000 lekë.

²⁷ Datë 29.05.2009, vlerë 10.000 lekë dhe datë 01.06.2009, vlerë 20.000 lekë (tërhequr nga bashkëshorti i subjektit).

²⁸ Shumat 1.389.275 lekë dhe 2.814.608 lekë.

e tri debitimeve të mësipërme (4.112.500 lekë) është pothuajse e barabartë me shumën e deklaruar *cash* nga subjekti (4.200.000 lekë).

20.6. Në DIPV-në e vitit 2010, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: (i) depozitë në Bankën Popullore, çelur si llogari rrjedhëse më datë 15.12.2010, në pronësi me vjehrrin, nga vlera *cash* e derdhur më parë, plus kontribut nga dividendi i vitit 2010, vlera 20.000 euro; pjesa takuese 50%. (ii) Depozitë në Union Bank, datë 15.12.2010, në pronësi me vjehrrin; nga vlera *cash* e derdhur më parë, plus kontribut nga dividendi i vitit 2010, vlera 20.000 euro; pjesa takuese 50%.

Nga lëvizjet e llogarive rezulton se në datën 15.12.2010 u kryen dy depozitime në llogaritë dyemërore në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, konkretisht, depozitim: (1) në vlerën 20.000 euro pranë Union Bank, me përshkrim: “*Depozitim në llogari, A. C.*” dhe (2) depozitim në vlerën 20.000 euro pranë OTP Bank, me përshkrim: “*Depozituar nga A. C. ose Th. L. / A. C.*”.

20.7. Për sa i përket depozitës (1) pranë Union Bank, konstatohet se në datën 17.12.2010, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 20.000 euro (të depozituar dy ditë më parë) dhe, në të njëjtën datë, ka depozituar vlerën 2.776.000 lekë, me përshkrim: “*Depozitim cash, Th. L., këmbim me kurs preferencial*”²⁹, e cila ka kaluar në depozitë me afat. Pas maturimit të kësaj depozite, në datën 19.12.2011, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 2.790.418 lekë dhe, po në këtë datë, ka kryer një depozitim në vlerën 2.776.000 lekë në një llogari tjetër pranë Union Bank, në emër të babait të subjektit. *Pikërisht ky depozitim është origjina e depozitës prej 2.770.000 lekësh, e ndodhur në një llogari në emër të babait të subjektit, e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, nga bashkëshorti i subjektit*³⁰.

20.8. Për sa i përket depozitës (2) pranë OPT Bank, konstatohet se, gjatë vitit 2011, bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr shumën 20.000 euro, të depozituar në vitin 2010, si dhe ka depozituar shumën 2.778.400 lekë, në llogarinë dyemërore të babait dhe të tij, në një llogari në monedhën *lekë* pranë kësaj banke³¹. Në datën 14.02.2011, bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr të gjithë shumën që kishte depozituar në llogarinë *në lekë* pranë OTP Bank dhe, po në të njëjtën datë, është kryer një depozitim në vlerën 2.788.000 lekë, në llogarinë e babait të subjektit, pranë Intesa Sanpaolo Bank. *Pikërisht ky depozitim është origjina e depozitës prej 2.800.000 lekë, e ndodhur në një llogari në emër të babait të subjektit, e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, nga bashkëshorti i subjektit.*

20.9. Lidhur me burimin e krijimit të këtyre dy depozitave, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit shtesë nr. 1, deklaroi se burim i tyre janë të ardhurat nga emigracioni, të cilat janë krijuar përpara se ajo dhe bashkëshorti të lidhnin martesë ligjore. Sikurse rezulton nga nxjerrja e llogarisë bankare, vlera 2.000.000 lekë është depozituar më datë 30.04.2003, disa muaj përpara se subjekti të emërohej në funksionin e gjyqtares³². Më datë 18 maj 2004, bashkëshorti i subjektit ka depozituar

²⁹ Në llogarinë me numër {***}.

³⁰ Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar vlerën prej 2.776.000 lekësh, pra 6.000 lekë më shumë.

³¹ Konkretisht ka kryer këto transaksione: më datë 25.01.2011, ka tërhequr 13.000 euro dhe ka depozituar 1.807.000 lekë; më datë 08.02.2011, ka tërhequr 6.000 euro dhe ka depozituar 590.700 lekë; më datë 09.02.2011, ka tërhequr 1.000 euro dhe ka depozituar 390.700 lekë.

³² Shkresë nr. {***} prot., datë 03.11.2003, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Dekreti nr. {***}, datë 21.10.2003.

shumën 1.100.000 lekë në Bankën Kombëtare Tregtare. Burimi i krijimit për këtë shumë është tërheqja dhe mbyllja e aktivitetit të bashkëshortit si person fizik, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Vlorë, më datë 30.10.2001. Aktiviteti i personit fizik vijoi deri në fund të vitit 2003, kur mblodhi të gjitha arkëtimet nga klientët që mbetën pa likuiduar dhe u shit i gjithë malli gjendje, në emër të personit fizik. Fitimi i realizuar në vite, si dhe mbledhja e të gjitha arkëtimeve nga klientët është tërhequr nga personi fizik, duke mbyllur plotësisht aktivitetin në këtë shoqëri. Me mbylljen e vitit ushtrimor 2003, fitimet e tërhequra në fillim të vitit 2004, së bashku me kursimet deri në maj 2004, kanë krijuar shumën 1.100.000 lekë. Si përfundim, depozitimet e vlerave monetare në vitet 2003 dhe 2004 kanë si burim: të ardhurat nga emigracioni, nga firmat rentiere, të ardhurat nga aktiviteti si person fizik, si dhe nga paga. Depozitat janë maturuar dhe riinvestuar deri në vitin 2009.

20.10. Sa rezultat më sipër, Komisioni analizoi burimin e krijimit për shumën: (a) depozitim në vlerën 2.000.000 lekë, më datë 30.04.2003; (b) depozitim në vlerën 1.100.000 lekë, më datë 18.05.2004, në llogarinë dyemërore të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, pranë BKT-së; (c) të ardhurat e bashkëshortit nga dividendi gjatë periudhës 01.01.2010 – 15.12.2010,³³ në vlerën 1.352.000 lekë, e përlllogaritur si diferencë midis vlerës 5.552.000 lekë (40.000 euro të depozituara më datë 15.12.2010)³⁴ me vlerën 4.200.000 lekë³⁵.

20.11. (a) *Depozitim në vlerën 2.000.000 lekë, më datë 30.04.2003*

20.11.1. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ky depozitim ka pasur si burim të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit në vitet 1992 – 1997, si dhe të ardhurat nga firmat piramidale. Konkretisht, të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në periudhën 1992 – 1997 kanë qenë rreth 1.850.000 lekë dhe rreth 150.000 lekë janë përfituar nga interesat e vlerave të depozituara në shoqëritë rentiere. Në funksion të deklarimeve, subjekti paraqiti dokumentacion justifikues si më poshtë:

- *Deklaratë nga administratori i vetëm i shoqërisë “{***}” s.r.l., V. G., i cili deklaroi se bashkëshorti ka punuar në funksionin e magazinierit, në periudhën shkurt 1992 deri në nëntor 1995, me një pagë mujore 800.000 lireta.*

- *INPS / ekstrakt i llogarisë së sigurimeve shoqërore, datë 04.07.2023, me informacion mbi të ardhurat nga paga, të realizuara gjatë vitit 1996 dhe 2000. Për periudhën 01.07.2000 – 18.10.2000, bashkëshorti i subjektit rezulton se ka qenë i punësuar në Itali, në shoqërinë “{***}” s.r.l., duke përfituar të ardhura nga paga në shumën 4.658,44 euro.*

- *Dokumenti “tesserino” ku pasqyrohen të dhënat personale të bashkëshortit të subjektit dhe kodi i tij fiskal.*

20.11.2. Lidhur me të ardhurat nga interesat në firmat rentiere, subjekti i rivlerësimit paraqiti shkresën

³³ Më datë 15.12.2010 u kryen dy depozitime në llogaritë dyemërore në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, konkretisht, depozitim në vlerën 20.000 euro pranë Union Bank, me përshkrim: “Depozitim në llogari, A. C.” dhe depozitim në vlerën 20.000 euro pranë OTP Bank, me përshkrim: “Depozituar nga A. C. ose Th. L. / A. C.”.

³⁴ Depozitimi prej 20.000 eurosh në Union Bank është tërhequr dy ditë më vonë dhe është depozituar vlera 2.776.000 lekë. Edhe depozita prej 20.000 eurosh në OTP Bank u vlerësua në të njëjtën kundërvlerë në lekë.

³⁵ Gjendja e deklaruar cash në DIPP/2009, me burim fillestar dy depozitimet prej 2.000.000 lekë dhe 1.100.000 lekë, pranë BKT-së.

nr. {***} prot., datë 11.07.2023, nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, ku bëhet me dije se bashkëshorti, z. Th. L., ka pasur të depozituar në shoqërinë “{***}” kapitalin në shumën 437.430 lekë, se ka tërhequr shumën 34.995 lekë dhe ka pasur detyrim për të marrë në shumën 402.435 lekë. Subjekti deklaroi se bashkëshorti figuron si kreditor për këtë shumë që mbetet ende e pashlyer, ndërkohë që nuk gjenden të gjitha depozitimet e mëparshme të cilat janë tërhequr. Gjatë kësaj periudhe, një pjesë të interesave që përfitonte bashkëshorti e depozitonte në këto shoqëri, për këtë arsye, shuma neto e përfituar prej tij nga shoqëritë rentiere ka qenë rreth 150.000 lekë.

20.11.3. Komisioni, në qëndrimin përfundimtar lidhur me burimet e përdorura për depozitim të shumës 2.000.000 lekë, në datën 30.04.2003, analizoi se: (i) provohet qëndrimi i bashkëshortit të subjektit, Th. L., në shtetin italian, përpara lidhjes së martesës me subjektin, konkretisht, për vitin 1995 (referuar kartës së lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Italisë) dhe gjatë periudhës 01.01.1996 – 31.07.1996 (referuar ekstraktit të llogarisë së sigurimeve shoqërore). (ii) Subjekti ka paraqitur një deklaratë të z. V. G., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” s.r.l., i cili konfirmon se bashkëshorti i subjektit, z. Th. L., ka përfituar një pagë mujore prej 800.000 liretash italiane, gjatë periudhës shkurt 1992 – nëntor 1995. (iii) Deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer si burim (të ardhurat nga emigracioni). (iv) Depozitimi në llogari është kryer në datën 30.04.2003, përpara emërimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

20.11.4. Sa analizuar më lart, Komisioni krijoi bindjen se të ardhurat e përdorura për depozitim të datës 30.04.2003 janë përfituar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit gjatë punësimit të tij në shtetin italian, në pjesën e tyre më të madhe, në një kohë që nuk e kishte statusin e personit të lidhur dhe, për më tepër, ato janë përdorur si burim për financimin e një pasurie që provohet se është krijuar përpara emërimit në detyrë të subjektit, duke përjashtuar dyshimet se deklarimi i tyre mund të ketë lidhje me qëllimin për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara më pas, gjatë kohës kur subjekti ushtronte detyrën si gjyqtare. Komisioni vlerësoi se subjekti shpjegoi bindshëm burimin e këtyre të ardhurave, pra se ato vijnë nga emigracioni, dhe se subjekti nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave. Për pasojë, këto të ardhura nuk janë trajtuar nga subjekti në shkaqet e ankimit.

20.12. (b) *Depozitim në vlerën 1.100.000 lekë, më datë 18.05.2004, me burim krijimi aktivitetin e bashkëshortit si person fizik*

20.12.1. Në përgjigje të pyetësorit shtesë nr.1, subjekti deklaroi se burimi i krijimit për këtë depozitim është tërheqja dhe mbyllja e aktivitetit të bashkëshortit si person fizik. Bashkëshorti është regjistruar si person fizik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Vlorë, më datë 30.10.2001 dhe paraqiti 2 (dy) fletë *njoftim tatimi* për vitet 2001 dhe 2002, respektivisht me data 01.11.2001 dhe 29.03.2002³⁶. Aktiviteti i personit fizik ka vijuar edhe gjatë vitit 2003, periudhë në të cilën bashkëshorti ka krijuar edhe shoqërinë

³⁶ Për vitin 2001 është lëshuar “Fletë Njoftim Tatimi”, datë 01.11.2001, tatim gjithsej 15.000 lekë dhe, për vitin 2002, është lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Vlorë dokumenti “Fletë Njoftim Tatimi”, datë 29.03.2002, për aktivitetin e bashkëshortit si person fizik, me nivel xhiro deri në 2 milionë lekë, tatimi i paguar është në shumën 40.000 lekë, përkatësisht në shumën 25.000 lekë, më datë 29.03.2002 dhe 15.000 lekë, më datë 08.08.2002.

“{***}” ShPK, duke shtuar aktivitetin dhe krijuar bashkëpunim me furnitorët e huaj për importimin e artikujve të kancelarisë. Subjekti deklaroi se aktiviteti i personit fizik vazhdoi deri në fund të vitit 2003, kur mbledhi të gjitha arkëtimet nga klientët që mbetën pa likuiduar dhe u shit i gjithë malli gjendje, në emër të personit fizik. Fitimi i realizuar ndër vite, si dhe mbledhja e të gjitha arkëtimeve nga klientët është tërhequr nga personi fizik, duke mbyllur plotësisht aktivitetin në këtë shoqëri. Me mbylljen e vitit ushtrimor 2003, fitimet e tërhequra në fillim të vitit 2004, së bashku me kursimet deri në maj 2004, kanë krijuar shumën prej 1.100.000 lekësh.

20.12.2. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ:³⁷ (i) Vendimi i Gjykatës Vlorë për regjistrim Person Fizik nr. {***}, datë 30.10.2001; (ii) Certifikatë regjistrimi në organin tatimor, si biznes i vogël, me kod fiskal {***}, në emër të z. Th. L., me datë regjistrimi 01.11.2001; (iii) Fletënjoftim tatimi datë 29.03.2002, regjistrim i ri, tatim gjithsej 25.000 lekë, nga të cilat 20.000 lekë, për xhiro deri në 2 milionë lekë, dhe 5.000 lekë, për xhiro 2-5 milionë lekë³⁸; (iv) Fletënjoftim tatimi datë 29.03.2002, reregjistrim, tatim gjithsej 40.000 lekë, për xhiro deri në 2 milionë lekë,³⁹ Komisioni ka konstatuar se aktiviteti si person fizik, i bashkëshortit, është zhvilluar gjatë periudhës 2001 – 2002, ndërsa më datë 28.01.2003, është themeluar shoqëria “{***}” ShPK. Komisioni, deri në atë fazë të hetimit, ka konstatuar se provohet zhvillimi i aktivitetit si person fizik në vitin 2001 dhe 2002, dhe nuk provohet zhvillimi i këtij aktiviteti në vitin 2004, sikundër deklaroi subjekti në pyetësonin shtesë nr.1, si dhe se këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim në deklaratën e pasurisë *vetting*. Komisioni nuk përllogariti të ardhura për vitet 2001 dhe 2002 (*për të cilat rezultojnë të paguara detyrimet tatimore*), pasi subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* fitimin e realizuar nga ky aktivitet për këtë periudhë.

20.13. (c) *Të ardhurat nga dividendi (të bashkëshortit), periudha 01.01.2010 – 15.12.2010, në vlerën 1.352.000 lekë*

20.13.1. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, rezultoi se dividendi i shpërndarë në vitin 2010 ka qenë në shumën 540.000 lekë, ndërkohë që diferenca e depozitimeve me *cash-in* e pakësuar rezultoi në vlerën 1.352.000 lekë.

20.14. Në përfundim, Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2010 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, personave të lidhur dhe prindërve të subjektit. Në kushtet që depozitimi i shumës 40.000 euro⁴⁰ është kryer më datë 15.12.2010, analiza u krye për të gjithë vitin 2010, nga ku rezultoi një balancë negative prej (-) 1.029.846 lekësh. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e depozitave në Intesa Sanpaolo Bank dhe Union Bank, si në vijim: (i) në vlerën (-) 1.100.000 lekë, për kryerjen e depozitimit prej 1.100.000 lekë, më datë 18.05.2004, pasi

³⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 03.03.2023.

³⁸ Dorëzuar sërish nga subjekti me pyetësonin nr. 1.

³⁹ Dorëzuar sërish nga subjekti me pyetësonin nr. 1.

⁴⁰ Më datë 15.12.2010 u kryen dy depozitime në llogaritë dyemërore në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, konkretisht, depozitim në vlerën 20.000 euro pranë Union Bank, me përshkrim: “Depozitim në llogari A. C.”, dhe depozitim në vlerën 20.000 euro pranë OTP Bank, me përshkrimin: “Depozituar nga A. C. ose Th. L. / A. C.”.

mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar zhvillimin e aktivitetit të bashkëshortit si person fizik gjatë viteve 2003 – 2004 dhe, për rrjedhojë, nuk provohen as të ardhurat e realizuara; (ii) për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën (-) 1.029.846 lekë.

20.15. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se ka arritur të gjejë në arkivin e dokumenteve të aktivitetit të bashkëshortit, tabelën e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003, si dhe disa dokumente të tjera, që tregojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm vazhdimin e aktivitetit edhe pas regjistrimit të shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe ka paraqitur: (i) Formularin e vitit 2003, sipas të cilit rezultoi se qarkullimi i deklaruar për këtë vit është në shumën 3.000.000 lekë. Nëse marzhi i fitimit llogaritet 50% e qarkullimit, duke zbritur detyrimet e paguara, do të rezultojë në një fitim neto në vlerën 1.360.000 lekë. (ii) Deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.10.2023, e kontabilistit të bashkëshortit, V. Xh. (iii) Formularin e qarkullimit për vitin 2003, fitimi për periudhën 2001 – 2003 është i dokumentuar dhe duhet të përfshihet në analizën financiare.

20.15.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti pretendon se nuk është deklaruar fitimi i personit fizik, pasi nuk kanë pasur dijeni për mënyrën e llogaritjes së fitimit dhe pasqyrimin të këtij fitimi në deklaratë. Po ashtu, subjekti shpjegon se, më datë 15.12.2010, është çelur depozita në Bankën Popullore, në emër të babait A. Ç., në vlerën 20.000 euro, pjesa takuese e deklaruar nga bashkëshorti: 50%. Gjendja në këto depozita është me burim kursimet e prindërve të subjektit, që u depozituan së bashku me lekët që dispononte bashkëshorti. Për këtë arsye, bashkëshorti vendosi emrin e babait të subjektit dhe e ka lënë atë administrues të këtyre dy depozitave. Pavarësisht këtij fakti, në DPIV-në vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo depozitë nuk ishte vetëm e babait. Babai nuk ka qenë subjekt deklarues në vitin 2010 (prandaj nuk janë deklaruar edhe kursimet e tyre). Bashkëshorti ka deklaruar burimet e krijimit për mjetet monetare të kontribuara nga bashkëshorti, sikurse kanë qenë kursimet *cash*, në shumën 4.200.000 lekë dhe të ardhurat nga dividendi për këtë vit. Ndërkohë, babai, në cilësinë e mbajtësit të depozitave, ka kontribuar me kursimet *cash* që dispononte nëna, pasi bashkëshorti tërhoqi dy depozitat në Raiffeisen Bank ShA. Në analizën financiare për vitin 2010 duhet të përfshihen edhe kursimet *cash* të disponuara nga prindërit e subjektit, në shumën 1.200.000 lekë. Subjekti ka sjellë deklaratën noteriale, datë 16.10.2023, të babait të saj, i cili deklaroi se, pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes E. Ç., të gjitha kursimet që ai dhe bashkëshortja dispononin në *cash* janë depozituar në bankë së bashku me kursimet e vajzës Herila Çela dhe bashkëshortit të saj, Th. L. Me përfshirjen e kursimeve *cash* të disponuara nga prindërit, subjekti rezultoi se ka pasur mundësi financiare për të krijuar depozitat në vitin 2010, duke rezultuar me balancë pozitive në vlerën (+) 170.154 lekë.

20.16. Komisioni, sa i përket pretendimeve të subjektit lidhur me burimet e përdorura për depozitimin në shumën 1.100.000 lekë, në datën 18.05.2004, dhe për depozitimin e shumës 40.000 euro, në datën 15.12.2010 (origjina e dy depozitave të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*), konstatoi se burimet e deklaruara nga subjekti – të ardhurat nga aktiviteti si person fizik dhe kursimet e prindërve – nuk janë deklaruar në deklaratat vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këto kushte, Komisioni e vlerësoi të pabazuar pretendimin e subjektit, se për këtë depozitim ka shërbyer fitimi i realizuar në vite nga personi fizik. Lidhur me pretendimin e subjektit, se në analizën financiare për vitin 2010 duhet të përfshihen edhe kursimet *cash*, në shumën 1.200.000 lekë, të disponuara nga prindërit si burim për

depozitimin prej 40.000 eurosh, të kryer në datën 15.12.2010, Komisioni vlerëson se ky pretendim lidhur me burimin, i ngritur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, nuk qëndron. Në mungesë të deklarimeve në deklaratat periodike vjetore përjashtohet edhe një nga mundësitë që ka pasur subjekti i rivlerësimit për të provuar ekzistencën dhe përfitimin e kursimeve nga prindërit.

20.16.1. Lidhur me pretendimin se një pjesë e këtyre kursimeve të prindërve janë përdorur për depozitën prej 300.000 lekësh të babait, në BKT, Komisioni vëren se kjo depozitë është krijuar nëpërmjet llogarisë dyemërore (në emër të bashkëshortit dhe babait të subjektit) dhe, si e tillë, nuk i përket vetëm babait të subjektit, për më tepër, të dyja transaksionet që lidhen me këtë depozitë, referuar lëvizjeve të llogarisë të përcjella nga BKT-ja, janë kryer nga bashkëshorti i subjektit. Për këtë arsye, Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pretendim dhe shuma e zërit “Ndryshim i likuiditeteve në bankë (përveç shtimit të vlerës 40.000 euro)” mbeti e pandryshuar në analizën financiare. Mbetet i pandryshuar konkluzioni i Komisionit se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.029.846 lekë, për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010. Sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.100.000 lekë, për kryerjen e depozitimit në datën 18.05.2004.

20.17. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimeve të përsëritura të subjektit të rivlerësimit, sa i përket pasojave që sjell mungesa e deklarimeve, mban në konsideratë qëndrimin e tij, të konsoliduar tashmë, se pasaktësitë në deklarime periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Ndryshe nga jurisprudenca që sjell në vëmendje subjekti i rivlerësimit, në rastin e procesit të rivlerësimit të subjektit, ka rezultuar se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, nuk janë provuar me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Lidhur me referimet në jurisprudencën e Kolegjit, sa i përket kursimeve të prindërve, për të cilët subjekti pretendon se duhet mbajtur në konsideratë se nuk kanë qenë subjekte deklarimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, për shtesat në depozitat e investuara në vitin 2010, gjatë procesit të rivlerësimit, ka pretenduar se ato kanë burim dhurimin e kryer nga babai i subjektit të rivlerësimit, në shumën 1.200.000 lekë. Kjo vlerë, përveçse nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* apo deklaratat periodike vjetore si burim i krijimit të këtyre depozitave, është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas kalimit të barrës së provës në Komision, si dhe nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor, duke mbetur kështu në nivel deklarativ.

20.17.1. Sa i përket të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga aktiviteti tregtar si person fizik i bashkëshortit, në vitin 2003, ato u trajtuan edhe më lart në këtë vendim, pasi janë pretenduar nga subjekti si burim edhe për depozitën e krijuar në ish-Bankën e Kursimeve, në vlerën 539.346 lekë. Dokumentacioni i sjellë nga subjekti dhe provueshmëria e tij në drejtim të realizimit të tyre është trajtuar në shkaqet e ankimit lidhur me depozitën në ish-Bankën e Kursimeve. Për më tepër, nëse të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit do të përfshiheshin në analizën financiare për subjektin në periudhën 1997 – 2003, sikurse e pretendon subjekti, atëherë këto të ardhura nuk mund të shërbenin paralelisht edhe për krijimin e depozitës në vlerën 1.100.000 lekë, në vitin 2004.

20.17.2. Nga rikontrolli i analizës financiare të vitit 2010 në Kolegj, bazuar në dokumentacionin e administruar, burimet e deklaruara dhe të dokumentuara, si dhe të gjendjes *cash*, të deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore, të cilat janë provë në këtë proces, konfirmohen balancat negative të konstatuara nga Komisioni: (i) në vlerën prej (-) 1.100.000 lekësh, për kryerjen e depozitimit në datën 18.05.2004, si dhe (ii) në vlerën prej (-) 1.029.846 lekë, për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2010.

20.18. Në përfundim, në lidhje me dy depozitat, në vlerën 2.800.000 lekë, në Intesa Sanpaolo Bank, dhe në vlerën 2.776.000 lekë, në Union Bank, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e depozitimit në datën 18.05.2004, si dhe për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin 2010, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë “automjet”, tip “Nissan”

21. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 235.207 lekë, për blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 03.02.2007, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, lidhur me pamundësinë financiare të subjektit për të blerë këtë pasuri, është i gabuar. Subjekti në shkaqet e ankimit ngre të njëjtat pretendime si gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me faktin se: (i) pasaktësitë në deklarime duhet të konsiderohen si pasaktësi të karakterit formal; (ii) duke qenë në kushtet e një ekonomie të përbashkët familjare, subjekti, në momente të caktuara, ka përdorur edhe kursimet familjare të prindërve; (iii) shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhet të jenë si mesatare e vitit 2006 dhe 2008, pasi Komisioni i ka llogaritur më shumë se në vitin 2013, rreth 6 vite më vonë.

23. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, si dhe pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

23.1. Komisioni gjatë hetimit administrativ, nga aktet e përcjella nga ILDKPKI, ka konstatuar se bashkëlidhur procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit, që mban datën 27.03.2015, subjekti ka paraqitur: (1) Kontratë shitblerjeje nga bashkëshorti i subjektit, Th. L., për automjetin nr. {***} rep. / {***} kol., datë 03.02.2007, tip “Nissan”, viti i prodhimit 1998, me targë {***}, me çmim 350.000 lekë, si dhe (2) Kontratë shitblerjeje automjeti nr. {***} rep. / {***} kol., datë 19.04.2008, sipas së cilës Th. L. e ka shitur këtë mjet në vlerën 200.000 lekë⁴¹. Subjekti nuk e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPIV-2007 dhe as shitjen e tij në DPIV-2008, sipas parashikimeve të nenit 4, shkronjat “b” dhe “e”, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, sipas të cilit subjekti deklarues mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë.

23.2. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi nga analiza financiare deri më datë 03.02.2007,

⁴¹ Në cilësinë e blerësit, z. M. J.

duke konsideruar si burim vetëm të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, si dhe pensionet e prindërve të subjektit,⁴² duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën (-) 235.207 lekë, për blerjen e automjetit tip “Nissan”.

23.3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se përveç kursimeve nga paga deri në datën e blerjes së këtij automjeti, kanë shërbyer edhe të ardhurat familjare nga shitja e tokës truall, në shumën 1.000.000 lekë, sipas Kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2007. Duke qenë në një ekonomi të përbashkët familjare, bashkëshorti ka marrë shumën 250.000 lekë nga kursimet e mbajtura *cash* nga nëna dhe, pasi është shpërndarë dividendi dhe u pagua tatimi në burim për dividendin, në datën 30.08.2007, bashkëshorti ka tërhequr vlerën neto 720.000 lekë, duke ia kthyer nënës shumën 250.000 lekë. Subjekti pretendoi se shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhet të jenë si mesatare e viteve 2006 dhe 2008, pasi shpenzimet e jetesës së vitit 2007, përlllogaritur nga Komisioni, janë në vlera më të larta për frymë se shpenzimet e jetesës për vitin 2013, gjashtë vjet më vonë. Lidhur me pasaktësitë në deklaram, subjekti pretendon se nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri dhe nuk mund të shërbejnë si masë shkarkimi, bazuar në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit.⁴³

23.4. Komisioni ka arsyetuar se, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPV-2007 (për rrjedhojë, as burimin) dhe as shitjen e tij në DIPV-2008, vëren se një deklaram i plotë do të jepte qartësi se cilat kishin qenë burimet e përdorura për blerjen e këtij automjeti. Mosdeklarimi në DIPV- 2007 i blerjes së këtij automjeti dhe, për rrjedhojë, as i burimit të krijimit, ndonëse lidhet me pasaktësi të deklaratës periodike, e cila nuk mund të ngrihet në nivelin e një deklarami të pasaktë sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, sërish ka krijuar premisa për vështirësinë e verifikimit të burimeve financiare të krijimit. Në këto kushte, Komisioni nuk e gjen bindës pretendimin e subjektit se si burim krijimi kanë shërbyer edhe kursimet *cash* të nënës, për sa kohë kjo nuk është deklaruar në DIPV-në e vitit përkatës.

23.5. Trupi gjykues i Kolegjit, *së pari*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, ka pasur detyrimin të deklarojë çdo ndryshim/shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht, si dhe burimin e krijimit të saj. Në analizë të deklaratave periodike vjetore, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri dhe, rrjedhimisht, as burimin e krijimit të saj në DIPV-në e vitit 2007, po ashtu, as pakësimin e kësaj pasurie, me shitjen e saj në vitin 2008. Subjekti i rivlerësimit nuk ka saktësuar

⁴² Subjekti, në pyetësorin standard, ka deklaruar se, nga viti 1996 (momenti kur ka lidhur martesë), deri në vitin 2005, ka jetuar në familjen e prindërve të bashkëshortit dhe se nga viti 2005 e në vazhdim ka jetuar dhe jeton aktualisht pranë prindërve të saj.

⁴³ Subjekti referon vendimin nr. 37/2021 (JR) të Kolegjit: [...] 10.12 - Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me faktin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar shumën prej 18.000 eurosh, në vitin 2004, nuk është i saktë. Pavarësisht deklarameve jo të plota të subjektit në vitet 2003 – 2004, për pasurinë “likuiditet”, nga leximi dhe analiza logjike e deklarameve të bëra prej tij, qoftë në DIPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast, subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij, edhe në version e pranuar prej Komisionerit Publik, se ai zotëronte me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë, se pasaktësitë në deklaram periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. [...].

burimin e krijimit të kësaj pasurie as në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, bashkëlidhur të cilit ka paraqitur këto kontrata. Kjo pasaktësi, e shoqëruar edhe me pamjaftueshmëri, nuk mund të mbetet e karakterit formal, sikurse pretendon subjekti.

- *Së dyti*, në lidhje me pretendimin e subjektit, se si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer edhe kursimet *cash* të nënës, si dhe të ardhurat nga shitja e truallit, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit, i cili shoqëron në çdo rast shpjegimet e saj, në rastet kur analiza financiare ka rezultuar me pamjaftueshmëri, mbetet në nivel deklarativ, si dhe nuk u provua me dokumentacion justifikues, duke qenë se këto kursime nuk janë deklaruar si burim në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2007, kur është blerë pasuria, apo në procesverbalin e ILDKPKI-së. Në këto kushte, në nivel deklarativ mbeten edhe lëvizjet e pretenduara brenda ekonomisë së përbashkët familjare, në momentin e blerjes së automjetit, apo pas shpërndarjes së dividendit nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, të cilat nuk gjejnë referencë në deklaratën *vetting* apo deklaratimet periodike vjetore.

- *Së treti*, sa i përket pretendimeve të subjektit mbi përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, trupi gjykues sjell në vëmendje se mënyra e vlerësimit të këtij zëri përbën një qëndrim të konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit,⁴⁴ sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it për secilin vit të analizës financiare, përfshirë vitin 2007. Nga rikontrolli i analizës financiare në Kolegj u konfirmua balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në vlerën prej (-) 235.198 lekë, për blerjen e këtij automjeti.

23.6. Në përfundim, për pasurinë “automjet” tip “Nissan”, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e tij, në datën 03.02.2007, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me konfliktin e interesit

24. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit, pasi ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.
25. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, sikurse edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe parashtron argumente në drejtim të interpretimit dhe qëllimit të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”), sa i përket gjendjes së konfliktit të interesit, për kontratat e lidhura nga shoqëria tregtare e bashkëshortit me institucione publike. Subjekti pretendon se edhe duke abstraguuar nga të gjitha argumentet ligjore të trajtuara në shkaqet ankimore, por edhe sikur të supozohet se bashkëshorti i saj ka konsumuar këtë kundërvajtje, në kushtet kur nuk është konstatuar asnjë indicie e qenies së subjektit në keqbesim, kjo gjetje e Komisionit nuk mund të ketë ndikim në procesin e rivlerësimit të subjektit apo në marrjen e masës disiplinore ndaj saj. Në referencë të vendimit nr. {***}, datë 14.12.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, subjekti

⁴⁴ *Vendimet e Kolegjit nr. 18 (JR), datë 08.06.2022; nr. 32 (JR), datë 24.07.2023; nr. 53 (JR), datë 15.12.2023 dhe nr. 43 (JR), datë 19.09.2024.*

pretendon se ky konflikt tashmë është zgjidhur në rrugë gjyqësore, me vendim të formës së prerë dhe, si i tillë, nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

26. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, si dhe pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

26.1. ILDKPKI-ja, në “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit të rivlerësimit Herila Çela”, datë 19.11.2019, ka referuar se *Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), konfirmon se subjekti “{***}” ShPK është shpallur fitues dhe ka lidhur në total 42 kontrata me institucione të ndryshme publike, nga viti 2014 deri më 27.01.2017.* Rrjedhimisht, subjekti ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit, duke konkluduar se ka përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesit.

26.2. Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 03.03.2023, Komisioni administroi procesverbalin mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti në datën 30.06.2021 pranë ILDKPKI-së. Sipas këtij procesverbali, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë deklaruar se bashkëshorti i saj ka qenë ortak me 50% të aksioneve në shoqërinë “{***}” ShPK, me administrator J. Q., i cili është marrë me procedurat e prokurimeve publike. Deklaratat për konfliktin e interesit për prokurimet publike janë bërë nga administratori, i cili nuk është person i lidhur me subjektin. Sipas subjektit, bashkëshorti, ditën e nesërme nga dita e marrjes dijani, ka aplikuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”), për t’u çliruar nga vlera e aksioneve që ka në këtë kompani. Subjekti, në mbështetje të argumenteve të saj, ka paraqitur aplikimin pranë QKB-së, datë 01.07.2021, si dhe vendimin e Asamblesë së Ortakëve për shitjen e 50% të aksioneve të zotëruara nga ana e bashkëshortit Th. L., duke deklaruar se ka marrë të gjitha masat për të zgjidhur këtë situatë të ndaluar, sipas ligjit.

26.3. Nga aktet, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 25.10.2021, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, ka vendosur ndaj subjektit të rivlerësimit masën administrative dënim me gjobë, në shumën 200.000 lekë, me arsyetimin se nuk ka marrë masat e duhura ligjore për parandalimin sa më të hershëm të konfliktit të interesit “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, sipas kërkesave të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar. Subjekti ka kërkuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë shfuqizimin e vendimit të ILDKPKI-së, e cila, me vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 14.12.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës.

26.4. Nga ekstrakti historik i shoqërisë “{***}” ShPK rezultoi se bashkëshorti i subjektit, Th. L., ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë deri më datë 07.05.2018, kur me vendim të ortakut të vetëm është vendosur miratimi i shitjes së 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë në favor të z. J. Q. Ky fakt rrëzon pretendimin e subjektit, sipas së cilës ka qenë administratori J. Q. që është marrë me procedurat e prokurimeve publike, të paktën deri më datë 07.05.2018. Referuar vendimit të Asamblesë së Ortakëve, datë 01.07.2021, z. J. Q. bëhet ortak i shoqërisë me 100% të kuotave të kapitalit.

26.5. Komisioni, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 24.05.2023, kërkoi informacion nga APP-ja lidhur me të gjitha prokurimet publike ku shoqëria “{***}” ShPK ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese. Në përgjigje të kësaj kërkesë⁴⁵ rezultoi se ky subjekt tregtar ka lidhur kontrata me institucionet publike si vijon: (i) viti 2009 – 2 (dy) institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) viti

⁴⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 20.06.2023.

2010 – 7 (shtatë) institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Universiteti “{***}”, Vlorë etj.; (iii) viti 2011 – 2 (dy) institucione, Ujësjellës - Kanalizime Vlorë dhe Bashkia Vlorë; (iv) viti 2012 – 6 (gjashtë) institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Universiteti “{***}” Vlorë, Bashkia Vlorë etj.; (v) viti 2013 – 13 (trembëdhjetë) institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata e Apelit Vlorë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ujësjellës - Kanalizime Vlorë etj.; (vi) viti 2014 – 8 (tetë) institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Bashkia Vlorë, Këshilli i Lartë Gjyqësor etj.; (vii) viti 2015 – 4 (katër) institucione; (viii) viti 2016 – 5 (pesë) institucione, ndër to Bashkia Vlorë; (ix) viti 2017 – 2 (dy) institucione, ndër to Bashkia Vlorë; (x) viti 2018 – 3 (tre) institucione, ndër to Ujësjellës - Kanalizime Vlorë ShA, Bashkia Vlorë etj., si dhe është shpallur fitues në total në 6 (gjashtë) procedura; (xi) viti 2019 – 2 (dy) institucione, ndër to Bashkia Vlorë; (xii) viti 2020 – është shpallur fitues në 3 (tre) procedura me Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, Degën e Thesarit Tiranë dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë; (xiii) viti 2021 – është shpallur fitues në total në 4 (katër) procedura, ndër to Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, Ministria e Drejtësisë, Kuvendi etj.

26.6. Për sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me konstatimet se: (i) Shoqëria “{***}” ShPK, me ortak personin e lidhur / bashkëshorti i subjektit, Th. L., është shpallur fituese në disa prokurime publike dhe ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike. (ii) Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës, ku subjekti ushtron detyrën. (iii) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit. (iv) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti Th. L. nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të shmangur konfliktin e interesit⁴⁶.

26.7. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar se, për të qenë në kushtet e konfliktit të interesit, në të gjitha rastet, kërkohet që zyrtari, për shkak të interesave të tij privatë, të ketë ndikuar apo, në pamje, duket se ka ndikuar ose mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave të tij si zyrtar. Subjekti sqaron se jo vetëm nuk ka pasur dijeni, por edhe nuk ka pasur mundësi për të ndikuar *de facto* apo në dukje në procedurat e prokurimit publik, kjo për faktin se veprimtaria si gjyqtare zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe jo pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka në kompetencën e saj lëndore shqyrtimin e të gjitha konflikteve që lidhen me procedurat e prokurimit apo të konflikteve në zbatimin e kontratave me institucionet publike, të cilat janë të natyrës administrative, çka do të thotë se nuk mund të konsiderohet se ka pasur konflikt interesi, as në dukje.⁴⁷ Të ardhurat e përfituara nga kontratat e lidhura me institucionet publike zënë një

⁴⁶ Referuar nenit 21, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”. Në nenin 24, pika 1 e këtij ligji përcaktohet se: “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”.

⁴⁷ Subjekti pretendon se ligji duhet të interpretohet në tërësinë e tij dhe jo i fragmentarizuar, ashtu siç është formuluar dispozita e nenit 21/1, pasi një interpretim i tillë i ngushtë i ligjit, ndonëse nuk provohet që zyrtari/gjyqtari nuk ka pasur

përqindje të vogël në raport me të ardhurat e vitit dhe pjesa e fitimit të realizuar nga këto të ardhura në raport me fitimin e shoqërisë zë një pjesë shumë të vogël. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk e ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit, fakt tashmë i vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. {***}, datë 14.12.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendim i cili, për faktet e parashtruara, jo vetëm në pjesën e dispozitivit të tij, por edhe në pjesën arsyetuese, përbën gjë të gjykuar. Nuk rezultoi se nga ana e bashkëshortit të jetë konsumuar kundërvajtja administrative për shkak se, sipas pikës 4 të ligjit nr. 10279/2010, “Për kundërvajtjet administrative”, kundërvajtja administrative është shkelja me dashje, direkte e dispozitive ligjore. Hipotetikusht, shkelja e nenit 23 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, nga bashkëshorti apo shoqëria ku ai është ortak, nuk mund të përbëjë një gjetje, e cila mund të shërbejë për marrjen e masës disiplinore. Kjo kundërvajtje administrative, bazuar edhe në masën e gjobës së parashikuar (e cila fillon nga 10.000 lekë), paraqet një mospërbushje të vogël ligjore dhe shkallë rrezikshmërie të ulët. Në përfundim, subjekti referon për analogji arsyetimin e Kolegjit në vendimin nr. 14 (JR), datë 16.05.2022.

26.8. Komisioni ka arsyetuar se, referuar nenit 21, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në Kreun III, Seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”*. Në nenin 24, pika 1 e këtij ligji, përcaktohet se: *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”*.

26.9. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesave për arsye se: (i) bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës, ku subjekti ushtron detyrën. (ii) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime nga këto kontrata. (iii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, Th. L., nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të revokuar lidhjen e kontratave publike (interesat financiarë që rrjedhin prej tyre), për të shmangur konfliktin e interesit, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

26.10. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të situatës faktike dhe ligjore të konstatuar, gjen pa peshë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se të ardhurat e përfituara nga kontratat e lidhura me institucionet publike zënë një përqindje të vogël në raport me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë apo se veprimtaria e saj si gjyqtare zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe jo pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Masa e të ardhurave të përfituara nuk shëron faktin e provuar gjatë hetimit administrativ, se shoqëria “{***}” ShPK, në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qenë ortak

asnjë mundësi, qoftë dhe në dukje, që të ketë ndikuar në vendimmarrje, do të cenonte të drejtat dhe liritë ekonomike të shtetasve, të garantuara nga Kushtetuta (Kreu IV, neni 49, pika 1), sipas të cilit: “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.

i vetëm, më së paku deri më 07.05.2018⁴⁸, ka lidhur një numër të konsiderueshëm kontratash me institucione publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës, ku subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën si gjyqtare dhe jo vetëm për periudhën pas ndryshimeve ligjore të vitit 2014, të tilla si: Bashkia, Porti Detar, Ujësjellës-Kanalizime apo Gjykata e Apelit Vlorë, si dhe ka përfituar nga këto kontrata të ardhura nga fonde publike. Për më tepër, pika 1 e nenit 21, të ligjit nr. 9367/2003, i ndryshuar, detyrimin për prokurorët dhe gjyqtarët për të mos lidhur kontrata me institucione publike nuk e lidh vetëm me vendin në të cilin ata ushtrojnë detyrën, por e shtrin atë në të gjithë territorin e republikës. Trupi gjykues i Kolegjit, përtej pretendimeve dhe interpretimeve ligjore që ngre subjekti mbi qëllimin e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, si dhe ndryshimeve ligjore që ka pësuar neni 21 i tij, në vitin 2014, çmon se në çdo rast qëndron përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që, më së paku, të identifikonte këto aspekte dhe ndikimin që këto rrethana kanë në konstatimin apo perceptimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në kushtet që shoqëria tregtare ku bashkëshorti i saj ishte ortak i vetëm, lidhte kontrata publike me institucionet më të rëndësishme në qytetin, ku kjo e fundit ushtronte detyrën e gjyqtares apo dhe me vetë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

26.10.1. Trupi gjykues, në analizë të situatës faktike të rezultuar nga hetimi administrativ, pa u ndalur në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nr. {***}, datë 14.12.2022, vendim i cili është paraqitur nga vetë subjekti, vlerëson se ligji nr. 9367/2003, i ndryshuar, ndalon shprehimisht përfitimin e të ardhurave nga lidhja e kontratave me institucione publike për funksionarët publikë dhe personat e lidhur me to, ndaj çdo arsyetim mbi mungesën e pasjes dijeni, indicieve të keqbesimit, si dhe mundësisë apo jo të subjektit të rivlerësimit për të ndikuar në procedurat e prokurimit publik, për efekt të këtij procesi dhe rrethanave të konstatuara, mbetet e provuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë krijuar të ardhura dhe përfitime si pasojë e situatës së konstatuar të konfliktit të interesit.

26.11. Në përfundim, lidhur me konfliktin e interesit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë krijuar të ardhura e përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit, për shkak se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit

27. Komisioni, referuar konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive, nga analiza financiare e kryer për periudhën e rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 6.103.126 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

27.1. Subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit pretendon se balanca negative e konstatuar nga

⁴⁸ Bashkëshorti i subjektit, Th. L., ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë deri në datën 07.05.2018, ku me vendim të ortakut të vetëm, është vendosur miratimi i shitjes së 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë në favor të J. Q. Më pas, më datë 01.07.2021, J. Q. bëhet ortak i shoqërisë me 100% të kuotave të kapitalit. Ligji nr. 44/2014, në bazë të të cilit, në nenin 21 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, ndër zyrtarët e tjerë u përfshinë edhe gjyqtarët dhe prokurorët e Shkallës së Parë, ka hyrë në fuqi pasi është botuar në Fletoren Zyrtare, më datë 20.05.2014.

Komisioni duhet të korrigojohet sipas pretendimeve në shkaqet e ankimit dhe diferenca negative që rezulton, bazuar në parimin e objektivitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore. Sa i përket balancës negative në shumën (-) 268.906 lekë, për analizën financiare të periudhës 1997 – 2003, ajo duhet të merret me rezervë, duke qenë se vetë përgjigjja e Raiffeisen Bank ShA për krijimin e depozitës nuk është shteruese. Po ashtu, subjekti pretendon se edhe diferenca e rezultuar në vitin 2004 duhet të korrigojohet, duke qenë se subjekti arriti të paraqesë formularin e qarkullimit të vitit 2003, në shumën 3.000.000 lekë. Sipas subjektit, pas përlllogaritjes së fitimit mbi këtë xhiro, depozita e krijuar në datën 18.05.2004 do të rezultonte e ligjshme. Balanca negative prej (-) 1.029.846 lekësh, e rezultuar në vitin 2010, duhet të korrigojohet dhe, në këtë analizë, të përfshihen edhe kursimet e nënës të lëna *cash* pas ndarjes nga jeta. Subjekti pretendon se diferenca e vetme e krijuar pas emërimit të saj në detyrë është ajo e vitit 2011, në shumën (-) 136.325 lekë, e cila është krijuar në momentin e blerjes së automjetit tip “Chevrolet”.

27.2. Trupi gjykues i Kolegjit, për sa analizuar dhe konkluduar më sipër, në përfundim, vlerëson se edhe pas rishikimit të analizës financiare të kryer në Komision, përsëri, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për:

- (i) krijimin e depozitave në ish-Bankën Societe Generale Albania, në vlerën (-) 1.000.000 lekë;
- (ii) krijimin e depozitës në ish-Bankën e Kursimeve dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, në periudhën 1997 – 2003, në shumën (-) 848.073 lekë;
- (iii) krijimin e depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe Union Bank, në shumën (-) 2.129.846 lekë, pasi: (a) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën (-) 1.100.000 lekë, për kryerjen e depozitimit në datën 18.05.2004; (b) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën (-) 1.029.846 lekë;
- (iv) blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 03.02.2007, në shumën (-) 235.207 lekë.

27.3. Sa më sipër, nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara gjatë kësaj periudhe, për një total prej (-) 4.213.126 lekësh, duke u ndodhur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 28. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se, për shkak të faktit se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b” e “d”, të ligjit nr. 84/2016, si konkluduar më lart, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- 29. Trupi gjykues vlerëson se shkaqet e tjera të ankimit të paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se u gjenden të drejta, nuk janë të tilla që do të ndryshonin vlerësimin përfundimtar të Komisionit në drejtim të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 710, datë 30.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Herila Çela.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 03.11.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi